

# **KOMUNA SHTIME**

**PLANI KOMUNAL I  
VEPRIMIT PËR  
EFIÇIENCË TË  
ENERGJISË (PKVEE)  
2019-2021**



Npi - 01/31 datë: 30.01.2020

Duke u bazuar në nenet 12 pika (d), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr.03/L-040; Nenin 9 të Ligjit për Energjinë Nr.05/L-081 *(ku thotë Roli i qeverisjes lokale thotë se Organet e qeverisjes lokale duhet që në dokumentet e tyre zhvillimore të planifikojnë nevojat dhe mënyrën e furnizimit me energji dhe ato dokumente t'i harmonizojnë me Strategjinë dhe Programin për Zbatimin e Strategjisë, si dhe bilanceve të energjisë)*;

Nenin 6 të Ligjit për Eficiencën e Energjisë Nr.06/L-079; *(Ku thotë Plani i veprimit për eficiencë duhet të harmonizohet me planet komunale)*. Pastaj duke marrë për bazë edhe Udhëzimet e Agjencionit të Kosovës për eficiencë të energjisë – AKEE, si dhe Memorandumin e Mirëkuptimit në mes të Komunës së Shtimes dhe GIZ - GmbH, Projekti i Kosovës për eficiencën e energjisë (KEEP) për krijimin e sistemit të Menaxhimit të Energjisë në nivel lokal, Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e mbajtur më 30.01.2020, aprovoi këtë:

## Plani Komunal i Veprimit për Eficiencë të Energjisë (PKVEE) 2019 – 2021

Shtator 2019



Implemented by  
**giz**  
Deutsche Gesellschaft  
für Internationale  
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

**Deklarim:**

Ky Plan është mbështetur nga Qeveria Gjermane dhe implementuar përmes Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, Projekti i Kosovës për Eficiencë të Energjisë.

Studimi, mbledhja e të dhënave si dhe hartimi i planit është realizuar nga konsulenca e angazhuar nga GIZ: Studio "Links-4", falë bashkëpunimit dhe koordinimit të ngushtë me grupin punues të Komunës së Shtimes.

Pikëpamjet e hartueseve të këtij plani si dhe të dhënat e publikuara nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e GIZ-së.

Shkurtesat:

GIZ	Agjencia gjermane për bashkëpunim ndërkombëtar
MZHE	Ministria e zhvillimit ekonomik
AKEE	Agjencia e Kosovës për efikasitet të energjisë
PKVEE	Plani komunal i veprimit për efikasitet të energjisë
PKEE	Plani komunal i efikasitetit të energjisë
kWh	Kilovat orë
kWh/m <sup>2</sup> v	Kilovat orë për metër katror në vit
LED	Ndriçimi me dioda emetuese
MWh	Megavat orë
N A	Nuk aplikohet
ktoe	Kilo ton oil ekuivalent
KEDS	Kompania për shpërndarje dhe furnizim me energji
KAB	Korniza afatmesme buxhetore
EE	Efikasiteti i energjisë
IPCC	Paneli ndërqeveritar për ndryshimet klimatike

<b>1. HYRJE</b> .....	<b>9</b>
1.1. KONTEKSTI .....	10
1.1.1. OBJEKTIVAT E PKVEE .....	10
1.1.2. KORNIZA LIGJORE DHE POLITIKAT.....	10
1.1.3. PËRFITIMET E PRITURA NGA PKVEE.....	11
1.2. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE .....	12
1.2.1. POTENCIALI I PËRGJITHSHËM I KURSIMIT TË ENERGJISË.....	12
<b>2. INFORMATAT BAZË PËR KOMUNËN</b> .....	<b>14</b>
2.1. POZITA DHE TOPOGRAFIA .....	14
2.2. KLIMA .....	15
2.3. POPULLATA DHE VENDBANIMET.....	16
2.4. STRUKTURA ORGANIZATIVE .....	17
2.5. INDIKATORËT EKONOMIK DHE FINANCIAR .....	18
2.6. NDËRLIDHJA ME POLITIKAT LOKALE, NACIONALE DHE TË TJERA .....	20
2.7. PËRVOJA NË ZBATIMIN E MASAVE TË EFIÇIENCËS SË ENERGJISË .....	21
2.7.1. KAPACITETET PËR IMPLEMENTIMIN E PROJEKTEVE .....	21
<b>3. FURNIZIMI ME ENERGJI, PRODHIMI DHE DISTRIBUIMI</b> .....	<b>22</b>
3.1. FURNIZIMI ME ENERGJI .....	22
3.1.1. ENERGJIA ELEKTRIKE .....	23
3.1.1.1. Furnizimi me energji elektrike .....	23
3.1.1.2. Distribuimi i energjisë elektrike .....	23
3.1.2. DERIVATET E NAFTËS .....	23
3.1.2.1. Nafta.....	23
3.1.2.2. Benzina.....	23
3.1.2.3. Mazut .....	23
3.1.2.4. LPG .....	23
3.1.3. THËNGJILLI.....	23
3.1.4. BIOMASË DRURI .....	24
3.1.4.1. Dru zjarri.....	24
3.1.4.2. Pelet .....	25
3.1.4.3. Tjera .....	25
3.2. PRODHIMI I ENERGJISË .....	25
3.2.1. PRODHIMI I ENERGJISË PREJ BURIMEVE TË RIPËRTËRITSHME ( SOLARE FOTOVOLTAIKE, SOLARE TERMALE, POMPA TË NXEHTËSISË, ERA).....	25
3.2.2. PRODHIMI I ENERGJISË PËR NGROHJE QËNDRORE TË QYTETIT .....	25
3.3. PRODHIMI I ENERGJISË SIPAS SEKTORËVE.....	25
3.3.1. PRODHIMI I ENERGJISË NË EKONOMITË FAMILJARE (NDËRTESAT E BANIMIT) .....	25
3.3.2. PRODHIMI I ENERGJISË NË SEKTORIN E SHËRBIMEVE .....	26

3.3.2.1. Prodhimi i energjisë në ndërtesa komunale .....	26
3.3.2.2. Prodhimi i energjisë në sektori komercial, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme ..	27
3.3.2.3. Prodhimi i energjisë në shërbimet publike .....	27
3.3.3. <i>PRODHIMI I ENERGJISË NË INDUSTRI</i> .....	27
3.3.4. <i>PRODHIMI I ENERGJISË NË BUJQËSI</i> .....	27
3.3.5. <i>LËNDË TJERA PËR PRODHIMIN E ENERGJISË</i> .....	27
<b>4. ANALIZA E KONSUMIT TË ENERGJISË SIPAS SEKTORËVE.....</b>	<b>28</b>
4.1. KONSUMI I ENERGJISË NË NDËRTESAT PUBLIKE.....	28
4.1.1. <i>KONSUMI I ENERGJISË NË NDËRTESAT ADMINISTRATIVE</i> .....	30
4.1.2. <i>KONSUMI I ENERGJISË NË NDËRTESAT E ARSIMIT SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË</i> ....	30
4.1.3. <i>KONSUMI I ENERGJISË NË NDËRTESAT E NËN-SEKTORIT TË SHËNDETËSISË</i> .....	32
4.1.4. <i>KONSUMI I ENERGJISË NË NDËRTESAT E KULTURËS E SPORTIT</i> .....	33
4.1.5. <i>KONSUMI I ENERGJISË TE NDRIÇIMI PUBLIK</i> .....	34
4.1.6. <i>ANALIZA E STOKUT NDËRTIMOR</i> .....	35
4.1.1. <i>TË TJERA-INFRASTRUKTURA</i> .....	37
4.2. KONSUMI I ENERGJISË NË SHËRBIMET PUBLIKE .....	37
4.2.1. <i>KONSUMI I ENERGJISË NË FURNIZIMIN ME UJË DHE SEKTORIN E UJËRAVE TË ZEZA</i> .	37
4.2.2. <i>KONSUMI I ENERGJISË NË SEKTORIN E MBLEDHJES SË MBETURINAVE</i> .....	38
4.3. KONSUMI I ENERGJISË NË SEKTORIN E TRANSPORTIT .....	39
4.3.1. <i>FLOTA E AUTOMJETEVE KOMUNALE</i> .....	39
4.3.2. <i>TRANSPORTI PUBLIK</i> .....	41
4.4. KONSUMI I PËRGJITHSHËM I ENERGJISË.....	41
<b>5. ANALIZA E POTENCIALIT TË EFIÇIENCËS SË ENERGJISË SIPAS SEKTORËVE .....</b>	<b>42</b>
5.1. SEKTORI I SHËRBIMEVE.....	42
5.1.1. <i>NDËRTESAT PUBLIKE</i> .....	42
5.1.1.1. Ndërtesat e administratës .....	43
5.1.1.2. Ndërtesat e arsimit, shkencës dhe teknologjisë .....	43
5.1.1.3. Ndërtesat e mjekësisë familjare .....	44
5.1.1.4. Kultura dhe Sporti .....	44
5.1.1.5. Ndriçimi publik .....	44
5.1.1.6. Shërbimet komunale.....	44
5.1.2. <i>SHËRBIMET PUBLIKE</i> .....	45
5.2. BUJQËSIA .....	45
5.3. TRANSPORTI .....	45
5.3.1. <i>FLOTA KOMUNALE</i> .....	45
5.3.2. <i>TRANSPORTI KOMUNAL</i> .....	45
5.3.3. <i>POTENCIALI I KURSIMIT NGA SEKTORËT TJERË</i> .....	46
5.4. POTENCIALI I PËRGJITHSHËM I KURSIMIT TË ENERGJISË .....	46

<b>6. ANALIZA E EMETIMEVE TË GAZRAVE SERË DHE POTENCIALI PËR KURSIM .....</b>	<b>47</b>
<b>7. CAQET E KURSIMIT TË ENERGJISË.....</b>	<b>49</b>
<b>8. MASAT E EFIÇIENCËS SË ENERGJISË PËR TË ARRIT CAQET E KURSIMIT.....</b>	<b>49</b>
8.1. INFORMIMI DHE MASAT PËR NGRITJEN E KAPACITETEVE.....	49
8.1.1. MASAT PËR POLITIKAT KOMUNALE, PROMOVIM DHE NDRYSHIM TË SHPREHIVE .....	49
8.2. EFIÇIENCA E ENERGJISË SIPAS SEKTORËVE .....	51
8.2.1. Masat e efiçencës së energjisë në sektorin publik .....	51
8.2.1.1. Sektori i Administratës.....	52
8.2.1.2. Ndërtesat e arsimit, shkencës dhe teknologjisë .....	52
8.2.1.3. Sektori i shëndetësisë .....	56
8.2.1.4. Sektori i kulturës dhe sportit.....	58
8.2.1.5. Ndriçimi publik .....	58
8.2.1. SHËRBIMET PUBLIKE .....	58
8.3. BUJQËSIA .....	62
8.4. TRANSPORTI .....	58
8.4.1. FLOTA KOMUNALE DHE TRANSPORTI PUBLIK .....	58
<b>9. PLANI I VEPRIMIT.....</b>	<b>58</b>
9.1. ZBATIMI I MASAVE TË POLITIKAVE LOKALE, TË PROMOVIMIT DHE NDRYSHIMIT TË SHPREHIVE E SJELLJES.....	59
9.2. ZBATIMI I MASAVE TË EFIÇIENCËS SË ENERGJISË NË SEKTORIN PUBLIK .....	59
9.3. ZBATIMI I MASAVE TË EFIÇIENCËS SË ENERGJISË NË SHËRBIMET PUBLIK.....	60
<b>10. MONITORIMI DHE IMPLEMENTIMI I PLANIT TË VEPRIMIT .....</b>	<b>60</b>
10.1. MENAXHIMI I ENERGJISË KOMUNALE .....	60
10.2. KOORDINIMI .....	60
10.3. RAPORTIMI.....	61
10.3.1. MONITORIMI DHE RAPORTIMI BRENDA KOMUNËS .....	61
10.3.2. RAPORTIMI NË NIVELIN QENDROR (AKEE) .....	61
<b>11. MODELI DHE BURIMET E FINANCIMIT PËR IMPLEMENTIMIN E MASAVE TË EFIÇIENCËS SË ENERGJISË.....</b>	<b>62</b>
11.1. FINANCIMI NGA BUXHETI KOMUNAL .....	62
11.2. FINANCIMI NGA BUXHETI QENDROR .....	62
11.3. FINANCIMI NGA DONATORËT .....	62
11.4. FINANCIMI NGA FONDET E BE .....	62
<b>12. KONKLuzionET .....</b>	<b>62</b>
<b>13. REFERENCAT .....</b>	<b>63</b>

Tabela 1 - Potenciali i gjithmbarshëm për kursim në sektorin e ndërtesave publike .....	12
Tabela 2 - Potenciali për kursim në sektorin e ndriçimit publik .....	13
Tabela 3 - Masat e rekomanduara kumulative .....	13
Tabela 4 - Të dhëna me rëndësi për komunën e Shtimes .....	16
Tabela 5 - Buxheti i Komunës së Shtimes (Euro).....	19
Tabela 6 - Projektet e EE të zbatuara në 3 vitet e fundit në Komunën e Shtimes.....	21
Tabela 7 - Konsumi i lëndëve djegëse dhe energjisë elektrike, Shtime 2018.....	26
Tabela 8 - Ndërmarrjet publike .....	27
Tabela 9 - Konsumi i energjisë sipas sektorëve, viti 2018.....	28
Tabela 10 - Gjendja fizike e stokut ndërtimor.....	29
Tabela 11 - Konsumi i energjisë në ndërtesat administrative .....	30
Tabela 12 - Konsumi i energjisë në ndërtesat e nën-sektorit të arsimit.....	30
Tabela 13 - Shkollat me numer të nxënësve nën 84.....	31
Tabela 14 - Konsumi i energjisë në ndërtesat e shëndetësisë.....	32
Tabela 15 - Konsumi i energjisë në ndërtesat për kulturë e sport .....	34
Tabela 16 - Llojet e llambave dhe kapaciteti i instaluar.....	34
Tabela 17 - Konsumi i përgjithshëm sipas nën-sektorëve .....	35
Tabela 18 - Konsumi i energjisë në ndërtesat nën 80 kËh vit.....	36
Tabela 19 - Ndermarrjet publike.....	37
Tabela 20 - Shpenzimet e karburantit nga automjetet në pronësi të Komunës .....	40
Tabela 21 - Konsumi i përgjithshëm i energjisë nga automjetet komunale .....	40
Tabela 22 - Kumulativi i konsumit të energjisë në komunë.....	41
Tabela 23 - Potenciali i gjithmbarshëm për kursim në sektorin e ndërtesave publike .....	42
Tabela 24 - Potenciali i kursimit në ndërtesat e Administratës.....	43
Tabela 25 - Potenciali i kursimit në ndërtesat e arsimit, shkencës e teknologjisë .....	43
Tabela 26 - Potenciali i kursimit në ndërtesat e Shëndetësisë .....	44
Tabela 27 - Potenciali i kursimit në ndërtesat e Kulturës dhe Sportit .....	44
Tabela 28 - Llogaritja e potencialit të kursimit te sektori i ndriçimit publik.....	44
Tabela 29 - Potenciali i gjithmbarshëm për kursim në sektorin e ndërtesave publike .....	46
Tabela 30 - Llogaritja e potencialit të kursimit te sektori i ndriçimit publik.....	46
Tabela 31 - Faktorët e emisioneve të përdorura për përcaktimin e emisioneve të CO2 .....	47
Tabela 32 - Konsumi i lëndëve djegëse dhe energjisë elektrike, Shtime 2018.....	47
Tabela 33 - Konsumi i përgjithshëm i energjisë nga automjetet komunale .....	48
Tabela 34 - Kumulativi i konsumit të energjisë.....	48
Tabela 35 - Ndërtesat e rekomanduara për renovim .....	53
Tabela 36 - Ndërtesat e Shëndetësisë të rekomanduara për renovim.....	56
Tabela 37 - Përmbledhje e masave dhe veprimeve.....	63



Figura 1. Territori i Komunës së Shtimes .....	17
Figura 2. Organogrami i Komunës së Shtimes .....	18
Figura 3. Të dhëna nga KAB .....	19
Figura 4. Shpenzimet për energji dhe sipas sektorëve .....	20
Figura 5. Konsumi i lëndëve djegëse dhe energjisë elektrike me përqindje .....	26
Figura 6. Energjia specifike në ndërtesat e nën-sektorit të arsimit.....	32
Figura 7. Konsumi specifik i energjisë te ndërtesat shëndetësore .....	33
Figura 8. Konsumi specifik i energjisë te ndërtesat e kulturës dhe sportit .....	34

## 1. HYRJE

Bazuar në Direktivën për Eficiencën e Energjisë 2012/27/BE, që ka hyrë në fuqi më 5 dhjetor 2012, Bashkimi Evropian ka vendosur objektiva për reduktimin e konsumit të energjisë primare në 20% deri në vitin 2020. Të gjitha aktivitetet e institucioneve relevante në sektorin e energjisë rrjedhin nga nevojat për të përmbushur kërkesat e energjisë të vendit dhe përmbushjen e detyrimeve nga Traktati i Komunitetit të Energjisë. Republika e Kosovës si nënshkruese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë është përcaktuar të kontribuoj në arritjen e objektivave të eficiencës së energjisë, duke krijuar stimuj për kursimin e energjisë nga qytetarët, gjithashtu për hapjen e tregjeve dhe bizneseve të reja për aplikimin e teknologjive dhe shërbimeve efikase për energji.

Plani Kombëtar i Veprimit për Eficiencë të Energjisë në Kosovë ((2010-2018) ) është dokument bazik për implementimin e politikave për eficiencë të energjisë në Kosovë i miratuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik më 30 shtator 2011. Ai parasheh arritjen e caktimit indikativ prej 9% të 1021.08 ktoe deri në fund të periudhës së mbuluar me plan (2010-2018). Prandaj, sasia e energjisë që Kosova synon të kursej deri në vitin 2018 është 91.89 ktoe. Bazuar në konsumin aktual për periudhën afatshkurtër në fushën e kursimit të energjisë objektiv më i lartë është vendosur në sektorin e amvisërisë me 40% duke u pasuar nga sektori i shërbimeve me 30%. Përveç këtij aspekti, sektori i shërbimeve ka rol të rëndësishëm edhe për faktin se shumica e konsumatorëve të këtij sektori i takon sektorit publik, ndërsa sipas Direktivës 2006/32 / EC ky sektor duhet të jetë sektori kryesor drejt përmirësimit të kursimit të energjisë. Kjo do të thotë se përmirësimi i kursimit të energjisë në këtë sektor është thelbësor për të arritur objektivin përkatës në nivel vendi. Prandaj, hulumtimi i situatës aktuale dhe mbledhja e të dhënave gjithëpërfshirëse për konsumin e energjisë, parashikimi i kërkesës, ofrimi i mundësive alternative për përmbushjen e nevojave dhe identifikimi i mundësive për kursimin e energjisë në këtë sektor paraqet qëllimin kryesor të këtij Plani.

Në bazë të rritjes së zhvillimit ekonomik është paraqitur edhe rritja e konsumit të energjisë që kërkon nga qeveritë vendore që të ndërmarrin masa për kursimin e energjisë ose identifikimin e burimeve të ripërtëritshme për gjenerimin e energjisë.

Për të arritur caqet e nivelit nacional, komunat duhet të ndërmarrin plane konkrete ku do të identifikonin situatën aktuale të konsumit të energjisë, shpenzuesit më të mëdhenj, potenciali më i mirë për kursim si dhe masat e mundshme nëpërmjet projekteve konkrete.

PVKEE është një mjet që mund të ndihmojë komunat për një planifikim të tillë.

## 1.1. KONTEKSTI

Në vazhden e aktiviteteve për arritjen e caqeve për kursim të energjisë të cekura më lart, Komuna e SHTIMES me ndihmën e GIZ-it gjerman, janë zotuar që të përgatisin PKVEE.

Gjatë vitit 2015, komuna e Shtimes ka zhvilluar dhe adoptuar për të parën herë Planin Komunal për Efiçencë të Energjisë (PKEE), të miratuar nga Kuvendi Komunal. Përmes adaptimit dhe implementimit të PKEE, janë zhvilluar me sukses kapacitetet e strukturave komunale për të adresuar çështjet e energjisë. Përmes adoptimit të PKEE, Komuna e SHTIMES e ka identifikuar potencialin e objektivave për kursim të energjisë në sektorin e shërbimeve, sektorin e banimit, të transportit dhe sistemin e ndriçimit publik.

Planit Komunal i Veprimit për Efiçencë të Energjisë i komunës së Shtimes përcjellet me krijimin e softverit për menaxhim të energjisë në nivel lokal të quajtur Enmasoft.

### 1.1.1. OBJEKTIVAT E PKVEE

Objektivi i përgjithshëm i PKVEE është zvogëlimi i konsumit të energjisë, rritja e nivelit të KOMFORIT dhe ulja e barrës së shpenzimeve të energjisë në buxhetin komunal të Komunës së Shtimes.

Në gjendjen e Komunës së Shtimes pritet që PKVEE të ketë ndikimet e mëposhtme:

- Reduktimi i kostove të energjisë në buxhetin komunal;
- Reduktimi i konsumit të energjisë në sektorët e menaxhuar nga komuna;
- Përmirësimi i shërbimeve komunale;
- Renovimet e ndërtesave dhe instalimeve për prodhim të energjisë;
- Përmirësimi i kushteve sanitare dhe nivelit të rehatisë (komfortit) në ndërtesat publike;
- Zvogëlimi i emetimeve të CO<sub>2</sub> në të gjithë sektorët duke zbatuar masat e efiçencës së energjisë, duke përdorur burimet e ripërtëritshme të energjisë, duke menaxhuar konsumin, përmes trajnimit dhe masave të tjera;
- Ngritja e vetëdijes e vendimarrësve dhe përdoruesve të fundëm për kursim të energjisë.

### 1.1.2. KORNIZA LIGJORE DHE POLITIKAT

LIGJI I RI PËR EFIÇIENCËN E ENERGISË (Ligji Nr. 06/L -079), miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në Nëntor të vitit 2018, **Neni 6 - Planet Komunale të Veprimit për Efiçencë të Energjisë, zbatimi dhe raportimi**, përshkruan përgjegjësitë e Zyrave Komunale të Energjisë në zhvillimin e Planeve Komunale të Efiçencës së Energjisë dhe Raporteve të Progresit të Zbatimit të Planit Komunal të Efiçencës së Energjisë, sipas udhëzimeve të Agjencionit të

Kosovës për Eficiencë të Energjisë - AKEE. Të dy dokumentet duhet të miratohen nga Kuvendi Komunal dhe më pas të dorëzohen në AKEE.

LIGJI I RI PËR ENERGJINË (LIGJI Nr. 05/L -081) - Neni 9- Roli i qeverisjes lokale thotë se Organet e qeverisjes lokale duhet që në dokumentet e tyre zhvillimore të planifikojnë nevojat dhe mënyrën e furnizimit me energji dhe ato dokumente t'i harmonizojnë me Strategjinë dhe Programin për Zbatimin e Strategjisë, si dhe bilanceve të energjisë.

UDHËZIM ADMINISTRATIV (QRK) Nr. 09/2017, datë 6 shtator 2017, PËR ZYRAT E ENERGJISË KOMUNALE - përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e zyrave komunale të energjisë për të adresuar çështjet e planifikimit, zbatimit dhe monitorimit të politikave energjetike në nivel lokal. Ndër detyrat dhe përgjegjësitë e tjera të Zyrave Komunale të Energjisë më poshtë janë shënuar përgjegjësitë kryesore:

- të krijojë një bazë të dhënash dhe të mbajë një sistem informacioni për grumbullimin e rregullt të të dhënave për konsumin e energjisë në baza periodike, shpenzimet e energjisë dhe të dhëna të tjera relevante duke mbajtur një regjistër që mundëson përzgjedhjen e indikatorëve potencial të eficiencës së energjisë për ndërtesat komunale energjetike,
- të raportojë për zbatimin e PKVEE, dhe zhvillimet e pritshme në pjesën e mbetur të Programit,
- të zhvilloj aktivitetet e planifikimit të sektorit të energjisë, bazuar në Strategjinë e Energjisë, për të mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe social të komunave,
- të sigurojë të dhënat e nevojshme për Ministrinë përkatëse për përgatitjen e PKVEE-it, rishikimin dhe përgatitjen e Programit të Zbatimit të Strategjisë së Energjisë për tre (3) vjet në pajtim me Ligjin për Energjinë,
- të monitorojë vazhdimisht zbatimin e PKVEE në nivelin komunal dhe t'i raportojë Ministrisë për zbatimin e tij

#### 1.1.3. PËRFITIMET E PRITURA NGA PKVEE

Përfitimet që priten nga zbatimi i PKVEE janë të natyrës financiare, mjedisore dhe operacionale. Si të tilla do të numërohen kursimet në buxhetin komunal që vijnë nga zvoglimi i konsumit të energjisë si dhe zëvendësimi i lëndës së shtrenjt për prodhimin e energjisë me lëndë që kushton më pak, por edhe nuk ndot mjedisin.

## 1.2. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

PKVEE jep informacion mbi konsumin e energjisë në stokun e ndërtesave komunale - ndërtesat administrative, arsimore dhe shëndetësore, sektorin e ndriçimit publik dhe flotën e automjeteve komunale. Përmban synime, prioritete dhe afate specifike. Ky plan përfshin përdorimin e energjisë, disponueshmërinë e burimeve dhe reduktimin e emetimeve që shkaktojnë probleme të ndryshimeve klimatike. PKVEE tregon zonën që do të ndikohet si: kursime potenciale në stokun e ndërtesave të sektorit të arsimit në nivel komunal. Plani përfshin gjithashtu një plan zbatimi, identifikimi i masave adekuate me kursimet e mundshme të parashikuara dhe vlerësimet e nevojshme të parashikuara.

Me zhvillimin e këtij Plani Komunal të Eficiencës së Energjisë, Komuna e Shtimes promovon një strategji të qëndrueshme afatgjatë dhe një plan specifik për arritjen e objektivave mjedisore dhe ekonomike. E rëndësishme së veçantë është vlerësimi i potencialit të kursimit dhe sektorët me potencial më të madh.

### 1.2.1. POTENCIALI I PËRGJITHSHËM I KURSIMIT TË ENERGJISË

Potenciali për kursim të energjisë është analizuar në dy sektorë: Stokun e ndërtesave komunale në komunën e Shtimes që përbëhet nga ndryshime / përmirësime realisht të arritshme duke krahasuar konsumin aktual të energjisë dhe konsumin e energjisë pas zbatimit të masave të qëndrueshme të eficiencës së energjisë dhe Ndriçimin Publik në Komunën e Shtimes që përfshinë ndrrimin e llambave të Zhivës me Llamba LED.

Vlera e potencialit për eficiencë energjetike është përcaktuar nga parametrat e mëposhtëm:

- Kushtet aktuale,
- Investimet e nevojshme,
- Niveli real i zbatimit të masave të eficiencës së energjisë.

Potenciali për kursimin e energjisë është si më poshtë:

Tabela 1 - Potenciali i gjithmbarshëm për kursim në sektorin e ndërtesave publike

Nësektori	Potenciali i kursimit [MWh vit]
Administratë	94.2
Arsim	1081.4
Shëndetësi	206.3
Kulturë/sport	00
Gjithsej	1381.9

Tabela 2 - Potenciali për kursim në sektorin e ndriçimit publik

Llamba zhive				Llamba LED			
Nr. llambave	Kapaciteti	Gjithsej kapaciteti	Konsumi vjetor	Kapaciteti	konsumi pas intervenimit	Konsumi vjetor	Kursimi
Copë	W	W	MWh	W	kw	MWh	MWh
68	50	3400	3.36	20	1360	1.35	2.0

## PLANI I VEPRIMIT

Dokumenti identifikon masat për ngritje kapacitetesh dhe vetëdijësim të banorëve të Komunës së Shtimes për rëndësinë e kursimit të Energjisë, masat për renovime të stokut të ndërtesave publike sipas radhës së përcaktuara në bazë të kriterëve të përvetësuar, masat për deponim qendrorë të biomasës dhe prezanton Planin e Veprimit me masa konkrete.

Efektet e masave të rekomanduara rezultojnë me vlerat sikur në tabelën në vijim.

Tabela 3 -Masat e rekomanduara kumulative

Sektori	Kursimet [MWh/ vit]	Investime per tri vite [EUR]	Kursimet CO <sub>2</sub> [tCO <sub>2</sub> vit]
Politika komunale, promovim	/	106,000	/
Ndërtesat komunale	395	622,750	155.6
Ndriçimi publik	2	3,000	2.8
<b>Gjithsej</b>	<b>397</b>	<b>731,750</b>	<b>158.4</b>

## 2. INFORMATAT BAZË PËR KOMUNËN

Komuna e Shtimes gjendet në pjesën qendrore të Kosovës dhe përfshin qytetin e Shtimes dhe 22 fshatra me një popullsi prej 27,324 banorë me rreth 4.158 familje dhe me një dendësi popullore 203.91 banorë / km<sup>2</sup> dhe moshë mesatare 27.62 vjeç. Qyteti i Shtimes, qendra administrative e komunës ka klimë kontinentale me rreshje mesatare 673 mm në vit dhe temperatura mesatare - 1.4 °C në Janar dhe 20.6 °C në Korrik.

Në vendbanimet e komunës së Shtimes gjenden gjurmë të trashëgimisë historike e kulturore që prej kohës së Neolitit, Ilirëve, Romakëve dhe vazhduar me ato të Perandorisë Osmane. Sipas regjistrimit kadastral të vitit 1455 Shtimja i takonte Vilajetit të Vushtrrisë dhe ishte nën pushtimin Osman. Në vitin 1566-74 i takonte Nahijes së Moravës me qendër në Prishtinë. Ndërsa në shekullin XIX i takonte Sanxhakut të Prizrenit. Komuna Shtime ka një sipërfaqe prej 134 km<sup>2</sup> (13.450,8 ha) dhe shtrihet në pjesën qendrore të Kosovës, kufizohet me komunën e Ferizajt, Lipjanit dhe Therandës (Suharekës). Qendra administrative, qyteti i Shtimes është 31 km larg kryeqytetit të Kosovës - Prishtinës, 45 km larg Prizrenit dhe 13 km nga qyteti i Ferizajt.

Komuna ka 23 vendbanime duke përfshirë qytetin e Shtimes dhe 22 fshatra, prej të cilave 13 shtrihen në pjesën kodrinore – malore, ndërsa 9 prej tyre në pjesën rrafshinore. Shumica e fshatrave të komunës janë të lidhura me Shtimen me rrugë të asfaltuara.

### 2.1. POZITA DHE TOPOGRAFIA

Qytetin e Shtimes e përshkon lumi më i rëndësishëm Shtimjanja, në të cilin, para hyrjes në Shtime, derdhen lumi Carraleva, Topilla dhe Mollopolci. Pellgu i këtij lumi ka një sipërfaqe prej 14 km<sup>2</sup> dhe prej burimeve të tij e deri te derdhja në lumin Sitnicë të Lipjanit, është i gjatë rreth 15 kilometra.

### Infrastruktura

Vet pozita qendrore gjeografike e komunës së Shtimes mundëson një komunikacion të mirë dhe mjaft efikas. Komuna e Shtimes karakterizohet me lidhje shumë të mira të komunikacionit rrugor të cilat ndihmojnë zhvillimin e transportit të udhëtareve dhe të mallrave. Magjistralla Prizren – Prishtinë ia ka shtuar rëndësinë dhe e ka ndihmuar shumë zhvillimin hapësinor dhe socio-ekonomik të komunës gjatë historisë. Në komunën e Shtimes ekziston niveli i katër kategorive të rrugëve (të klasifikuara në Kosovë), duke filluar prej rrugëve magjistrale e deri tek ato të pa kategorizuara. Rrjeta e rrugëve në komunën e Shtimes përbëhet nga:

- Rrugët Magjistrale (Prizren – Prishtinë dhe Shtime - Ferizaj)
- Rrugë Regjionale (Caralevë – Komaran, Gjurkoc – Koshare)
- Rrugë lokale (rrugët të cilat i lidhin gjithsej 23 vendbanime)
- Rrugë të pa kategorizuara (të cilat lidhin lagjet e fshatit si dhe i lidhin të gjitha hapësirat në të cilat zhvillohen aktivitete socio-ekonomike)

Transporti publik organizohet nëpërmjet autobusëve, kombi-busëve dhe automjeteve të tjera të transportit. Shikuar nga numri i banorëve që kanë transport publik, nga gjithsej 21 komuna kadastrale (vendbanime) sa ka komuna e Shtimes, 16 prej tyre kanë qasje në transport publik, përderisa vetëm 5 vendbanime nuk kanë qasje në transportin publik.

Pozita gjeografike e komunës i mundëson edhe një rrjet të rëndësishëm, të furnizimit me energji elektrike. Përveç linjave të furnizimit me energji elektrike me kapacitet 35 kv, të cilat vijnë nga dy drejtime, në territorin e komunës kalon edhe linja transite e tensionit të lartë 110 KV Bibaj, Shirok-Prizren. Kjo linjë shfrytëzohet nganjëherë nga komuna e Shtimes dhe anasjelltas, varësisht prej kërkesës për shfrytëzim, që karakterizohen si linja nacionale që e lidhin Ferizajn me Suharekën dhe ka gjatësi prej 11.76 km.

Furnizimi i qytetarëve të Shtimes me energji elektrike, bëhet nëpërmjet të linjës së Lipjanit me kapacitet prej 35 KV deri tek trafo-stacioni kryesor, i cili gjendet ne komunën kadastrale të Shtimes dhe ka gjatësi prej 5.35 km.<sup>1</sup>

Vitet e fundit ka pasur disa investime të vogla nga ana e KEDS. Është rehabilituar rrjeti dhe trafot në Reçak. Një trafo në qytet 'kulla' është ndërruar dhe është punuar rrjeti i tensionit të ultë duke ndërtuar kanal kabllorik në qytet (pjesërisht).

Disa trafo nga dalja Carraleva kanë kaluar në daljen Petrova, me qëllim të shkarkimit të daljes Carralevë.

## 2.2. KLIMA

Rajoni i Komunës së Shtimes ka klimë të mesme kontinentale me dimëra relativisht të butë dhe verë mesatarisht të nxehta. Temperatura mesatare vjetore është 10.5 °C, temperatura e përgjithshme vjetore është 3 °C. Muaji më i ftohtë është Janari me – 9 °C, ndërsa muaji më i ngrohtë është Korriku me 20.4 °C. Periudha pa ngrica mesatarisht është 186 ditë. Sasia mesatare e të reshurave në këtë rajon është rreth 647 mm, ndërsa gjatë muajit prill - shtator rreth 309 mm. Mungesa e të reshurave gjatë periudhës së thatësisë është përafërsisht 350 mm (3500 m<sup>3</sup>/ha) . Mesatarja vjetore relative e lagështisë së ajrit është 78.7 % ndërsa ajo në sezonin e vegjetacionit është 70% që këtë rajon e bënë të klasifikohet në vend me lagështi mesatare.

<sup>1</sup> Plani zhvillimor komunal – SHTIME Përgatiti: Data GIS- consulting Shtator, 2009



Insulacioni gjatë vitit është 2.153 orë ndërsa në sezonin e vegjetacionit 1.523 orë. Vranësiat mesatare vjetore të këtij rajoni janë 52% dhe 41% (sez.vegj.) Shpejtësia mesatare vjetore e erës është 1.3 m/s me erën më të fortë të drejtimit jug – perëndim dhe veri – perëndim është 2.8 m/s.

### 2.3. POPULLATA DHE VENDBANIMET

Në bazë të Regjistrimit të popullsisë të vitit 2011 – CENSUS 2011 komuna e Shtimes ka 27,288 banorë. Në zonën urbane, gjegjësisht në qytet jetojnë 7,255 banorë, kurse në zonat rurale – 20,069 banorë.

Të dhëna të rëndësishme gjeografike e demografike janë dhënë në tabelën në vijim:

Tabela 4 - Të dhëna me rëndësi për komunën e Shtimes

<u>Komuna</u>	<u>Shtime</u>
<u>Adresa</u>	<u>Rruga Tahir Sinani, Shtime 72000</u>
<u>Rejioni</u>	<u>Ferizaj</u>
<u>Kodi postal</u>	<u>72000</u>
<u>Ueb faqja</u>	<u>www.kk.rks.gov.net/shtime</u>
<u>Sipërfaqja</u>	<u>134 km<sup>2</sup></u>
<u>Numri i fshatrave/vendbanimeve</u>	<u>22/23</u>
<u>Numri i popullsisë</u>	<u>27288 banorë</u>
<u>Numri i ekonomive familjare</u>	<u>4150</u>
<u>Popullsia në zona urbane</u>	<u>7255 banorë</u>
<u>Zona urbane</u>	<u>1531 ha</u>
<u>Densiteti</u>	<u>203 banorë/km<sup>2</sup></u>
<u>Familja mesatare</u>	<u>6.58 anëtarë/familje</u>
<u>Toka bujqësore</u>	<u>5609 ha</u>
<u>Pyje</u>	<u>6197.25</u>
<u>Klima</u>	<u>Kontinentale</u>
<u>Gjatësia e sezonit të ngrahjes</u>	<u>185 ditë</u>

Komuna e Shtimes është e organizuar në 21 njësi kadastrale me 23 vendbanime. Zona e ndërtuar e saj arrin në 194 ha, ose 15.1% të territorit dhe, dendësia e banimit në 46 b/h.

Karakteristikë e rrjetit të vendbanimeve në komunën e Shtimes është numri më i madh i vendbanimeve, i grupit të madhësisë së mesme, ndërsa gati gjysma e territorit (viset kodrinore-malore mbi 700 m) është e banuar shumë rrallë dhe me vendbanime të vogla. Në zonën e ulët nën 700 m ka më së shumti vendbanime të kategorisë 1000-2000 banorë (vendbanime të

mesme të mëdha) 5 vendbanime nga gjithsej 7 sa janë në territorin e komunës, ose 85.7 % të kësaj kategorie dhe vendbanimet e mëdha (mbi 2000 banorë) janë 5 vendbanime, që të gjitha shtrihen në këtë zonë. Zona kodrinore-malore mbi 700 m karakterizohet me vendbanime të vogla të kategorisë deri 500 banorë, ose 80% të kësaj kategorie. Vetëm vendbanimi Zborc ka 1203 banorë, që i takon kategorisë së mesme të vendbanimeve. Numri më i madh i vendbanimeve ka pasur rritje nga viti 1991-2004 (16 vendbanime, ose 76.2%). Vendbanimet tjera (5 vendbanime, ose 23.8%) paraqesin zona shpopulluese.




Figura 1. Territori i Komunës së Shtimes

#### 2.4. STRUKTURA ORGANIZATIVE

Struktura organizative e Komunës së Shtimes është paraqitur në organogramin e mëposhtëm.




Figura 2. Organogrami i Komunës së Shtimes

Komuna e Shtimes ka emëruar Menaxherin e Zyrës për Energji, z. Gojart Bajrami. Të dhënat e përgjithshme për komunën në këtë dokument janë siguruar nga web faqja e Komunës së Shtimes.

## 2.5. INDIKATORËT EKONOMIK DHE FINANCIAR

Komuna e Shtimes ka të hartuar dhe aprovuar Kornizën afatmesme buxhetore (KAB) për vitin 2018-2020. Të hyrat vetanake të komunës Shtimes realizohen në bazë të Rregullores mbi Tarifat dhe Ngarkesat Komunale, Rregullores mbi tatimin në Pronë si dhe dispozitave tjera ligjore të cilat përcaktojnë llojet e ndryshme të të hyrave komunale me të cilat komuna ka të drejtë të caktoj dhe inkasoj siç janë licencat e bizneseve dhe të hyrat tjera vetanake komunale. Bazën e të hyrave komunale e përbëjnë Tatimi në pronë të cilat të hyra duhet shpenzuar ekskluzivisht në sferën e projekteve për investime kapitale në infrastrukturën rrugore, ujësjellës, kanalizim<sup>2</sup>.

Buxheti komunal sipas këtij dokumenti është dhënë në figurën më poshtë:

<sup>2</sup> Korniza afatmesme buxhetore 2018-2020

Organizatrat buxhetore	Vlersimi	Projeksioni	Projeksioni provuses	
	2017	2018	2019	2020
Granti I Përgjithshëm	2,184,912	2,532,092	2,769,956	3,115,985
Granti për Arsim	2,769,058	2,800,749	2,932,384	3,093,665
Granti për Shëndetësi	676,722	744,394	818,834	925,282
Shërbimet Rezidenciale	160,000	160,000	160,000	160,000
Te hyrat vetanake	573,460	435,192	451,114	467,036
Iluamarrja në Arsim		8,533	4,977	
<b>TOTALI ;</b>	<b>6,364,152</b>	<b>6,680,960</b>	<b>7,137,265</b>	<b>7,761,968</b>

Buxheti i planifikuar për vitin 2018

Paga & Mëditje	Mallra & Shërbime	Shpenzime Komunale	Subvencione & Transfere	Shpenzime Kapitale	Gjithsej
4,118,537	592,936	178,132	118,688	1,672,667	6,680,960

Figura 3 - Të dhëna nga KAB

Shpenzimet për energji llogariten duke përdorur konsumin e energjisë të raportuar nga komuna dhe çmimet mesatare specifike të karburanteve dhe energjisë elektrike.

Tabela 5 - Buxheti i Komunës së Shtimes (Euro)<sup>3</sup>

<u>Shtime</u>	<u>2018</u>
<b>Buxheti total</b>	<b>€ 7.752.292,00</b>
<b>Fatura e përgjithshme e energjisë</b>	<b>€ 246.378,87</b>
<i>Ndërtesat publike – (përfsh. Energjinë elektrike, termike)</i>	€ 171.993,50
<i>Ndriçimi publik</i>	€ 54.991,21
<i>Automjetet e komunës (karburantet)</i>	€ 19.394,16

Komuna e Shtimes ka shpenzuar afërsisht 7% të buxhetit të saj për të mbuluar kostot e energjisë respektivisht 54991.21 €. Shpenzimet llogariten duke përdorur konsumin e energjisë të raportuar nga komuna dhe çmimet mesatare specifike të karburanteve dhe energjisë elektrike.

<sup>3</sup> Burimi I informatave-Komuna e Shtimes

Shpenzimet komunale për lëndë djegëse, karburante dhe energji elektrike për vitin e kaluar raportues shprehur në terma financiar mund të gjenden në grafikun e mëposhtëm.




Figura 4. Shpenzimet për energji dhe sipas sektorëve

## 2.6. NDËRLIDHJA ME POLITIKAT LOKALE, NACIONALE DHE TË TJERA

Ky dokument ndërlidhet me politika tjera relevante lokale, nacionale dhe ndërkombëtare.

### Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal 2014 - 2018

QELLIMI 1 – TË KRIJOHET NJË KLIMË E FAVORSHME PËR ZHVILLIMIN E BIZNESIT

QELLIMI 2 – TË PËRMIRËSOHET CILËSIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE DHE IFRASTRUKTURËS

QELLIMI 3 – TË ZHVILLOHET TURIZMI RURAL

QELLIMI 4 – TË PROMOVOHET ZHVILLIMI I BUJQËSISË INTENSIVE

QELLIMI 5–TË KRIJOHET NJË MJEDIS I FAVORSHEM SOCIO-KULTUROR, ARSIMOR DHE EKOLOGJIK

QELLIMI 6 – TË PROMOVOHET SHFRYTËZIMI I BURIMEVE NATYRORE

**Plani Komunal i Efiçencës së Energjisë 2015-2020 (PKEE)** është realizuar në përputhje me dispozitat e Ligjit për Efiçencën e Energjisë 04 / L-016 dhe paraqet dokumentin e parë ligjor të Komunës i cili është përqëndruar në adresimin e energjisë, efiçencën e energjisë dhe zvogëlimin e CO<sub>2</sub> brenda nivelit lokal. Plani shpreh angazhimin e qartë se si plani komunal funksionon në çështjet e energjisë, ndryshimet klimatike në përgjithësi, dhe efikasitetin e

energjisë në veçanti. PKEE adreson konsumin e energjisë në ndërtesat komunale dhe ndriçimin e rrugëve bazuar në analizat për tri vite: 2011, 2012 dhe 2013. Ai i paraqet fushat të cilat do të ndikohen si: potencialin për kursime në stokun e ndërtesave publike komunale duke përfshirë edhe ndriçimin publik, kjo po ashtu përfshinë edhe koston e investimeve, planin e zbatimit dhe kursimet e vlerësuara potencial si dhe liston projekte për realizimin e caqeve.

## 2.7. PËRVOJA NË ZBATIMIN E MASAVE TË EFIÇIENCËS SË ENERGIJISË

Në vitet e fundit, komuna e Shtimes ka realizuar projektet e mëposhtme që rezultojnë me përmirësim të efiçencës së energjisë të stokut të ndërtesave komunale dhe/ose ndriçimin publik. Sipas të dhënave buxhetore, komuna e Shtimes ka ndarë buxhet si në vijim për tri vite:

Tabela 6 - Projektet e EE të zbatuara në 3 vitet e fundit në Komunën e Shtimes

Emri i Projektit	Vlera monetare €	Vlera monetare €	Vlera monetare €
	v.2016	v.2017	v.2018
Ndërtimi, rindërtimi i ndriçimit publik Gjurkoc IOM			12,185
Rregullimi i trotuarve, ndriçim publik, gjelbrimi dhe shtegu për biçiklist në qytetin e Shtimes Qeveria Zvicerane	61,000	88,000	68,000
Rregullimi i ndriçimit publik			55,500
Renovimi i objekteve shëndetsore			4,900
Zgjerimi dhe renovimi i objekteve shkollore			15,500

### 2.7.1. KAPACITETET PËR IMPLEMENTIMIN E PROJEKTEVE

Administrata komunale është përgjegjëse për zbatimin e të gjitha detyrave ekzekutive të caktuara nga statuti dhe aktet e tjera normative komunale. Vendimet mirren në Asamblenë komunale. Komuna e Shtimes ka emëruar menaxherin për efiçencë të energjisë që do të shërbejë si koordinator me sektorët përkatës varësisht prej sektorit në të cilin realizohet projekti. Me krijimin dhe funksionalizimin e sistemit komunal për menaxhimin e energjisë dhe me vendosjen e të dhënave në softverin ENMASOFT, Menaxheri komunal i energjisë do të ketë më të lehtë menaxhimin e të dhënave nga terreni për ndërtesat komunale dhe ndriçimin publik, si dhe në krijimin e Planit Komunal të Veprimit për Efiçencë të Energjisë (PKVEE).

Ky është një mjet lehtësimi për realizimin e projekteve për EE nëpërmjet identifikimit më të lehtë të potencialit të kursimit si dhe përdorimit të këtyre të dhënave me sektorët tjerë relevantë.

### 3. FURNIZIMI ME ENERGJI, PRODHIMI DHE DISTRIBUIMI

#### 3.1. FURNIZIMI ME ENERGJI

Pozita gjeografike e komunës i mundëson edhe një rrjet të rëndësishëm, të furnizimit me energji elektrike. Përveç linjave të furnizimit me energji elektrike me kapacitet 35 kv, të cilat vijnë nga dy drejtime, në territorin e komunës kalon edhe linja transite e tensionit të lartë 110 KV Bibaj – Shirok – Prizren. Kjo linjë shfrytëzohet nganjëherë nga komuna e Shtimes dhe anasjelltas, varësisht prej kërkesës për shfrytëzim, që karakterizohen si linja nacionale që e lidhin Ferizajin me Suharekën dhe ka gjatësi prej 11.76 km që kalon në territorin e komunës. Furnizimi i qytetarëve të Shtimes me energji elektrike, bëhet nëpërmjet të linjës së Lipjanit me kapacitet prej 35 KV deri tek trafo-stacionit kryesor, i cili gjendet në komunën kadastrale të Shtimes dhe ka gjatësi prej 5.35 km.

Sa i përket objekteve në pronësi komunale, komuna ka përgjegjësinë për ngrohje, ndriçim dhe pajisje administrative. Sektori i banimit është shumë i rëndësishëm dhe jetësor për komunën, megjithatë komunat nuk kanë përgjegjësi për menaxhimin e energjisë në këto ndërtesa. Kompania për furnizimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike (KEDS) është përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve të energjisë elektrike në këtë komunë, megjithatë, konsumi i energjisë dhe shërbimet e tjera të lidhura me energji janë jashtë juridiksionit komunal.

Një sistem i mundshëm i ngrohjes qendrore në qytet do të zvogëlonte dukshëm konsumin e energjisë si në sektorin publik edhe privat në komunë.

Sektori i energjisë elektrike i ekonomive familjare dhe ndërtesave publike është një nga sektorët e rëndësishëm të konsumimit të energjisë në Komunën e Shtimes. Rëndësia e saj është theksuar nga fakti se konsumon sasi të mëdha të energjisë elektrike dhe lëndës djegëse, e cila ka kontribuar në krizën aktuale të rëndë të energjisë në vend.

Të gjitha këto argumente do të thotë se rajoni ka nevojë për konsum më të lartë të energjisë sesa pjesët e tjera të Kosovës, në sektorët e ekonomive familjare dhe publike.

Përdorimi në rritje i pajisjeve elektrike, mungesa e lëndës djegëse të drurit dhe çështje të tjera të lidhura, si qasja dhe çmimet, janë shqetësuese dhe mund të shkaktojnë probleme të mëtejshme në të ardhmen. Situata shkon e përkeqësohet nga prerjet e pakontrolluara të lëndës djegëse në zonat rurale. Kjo ndikon në nivelin dhe strukturën e furnizimit total të energjisë për këtë rajon.

Tani për tani, popullsia në Komunën e Shtimes ka përdorur më së shumti drurin si lëndë djegëse për ngrohjen e hapësirës.

Optimizimi i burimeve për energji, ujë dhe lëndë të tjera të papërpunuara do të ishte e nevojshme me rritjen e konsumit nga konsumatorë individualë dhe kolektivë siç janë komunitat. Për administratën e komunave në veçanti, optimizimi i burimeve në fushat e energjisë, ujit, mbeturinave dhe mjedisit do të jetë me rëndësi të madhe.

### 3.1.1. ENERGJIA ELEKTRIKE

Energjia elektrike është burimi i dytë më shumë i përdorur. Sikur përdoruesit individualë ashtu edhe kolektiv si Komuna e përdorin energjinë elektrike për pajisje, ngrohje, ndriçim dhe të ngjashme. Konsumi i energjisë elektrike për vitin 2018 në sektorin e ndërtesave komunale ishte 373 MWh/vit.

#### 3.1.1.1. FURNIZIMI ME ENERGJI ELEKTRIKE

Furnizimi me energji elektrike bëhet nga TC "Kosova B" derisa me dokumente planifikimi për EE rekomandohet burimi i energjisë me Erë si burim alternativ i energjisë.

#### 3.1.1.2. DISTRIBUIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE

Distribuimi i energjisë elektrike sikur u paraqit më lartë bëhet nga KEDS - Kompani distribuese.

### 3.1.2. DERIVATET E NAFTËS

#### 3.1.2.1. NAFTA

Në bazë të dhënave, derivati i vetëm që është përdorur në Komunën e Shtimes është nafta me 25,000 l/vit ose 270 MWh në vit. Nafta përdoret për ngrohjen e ndërtesës së Komunës, Shtëpisë të personave me aftësi të kufizuar dhe Qendra për punë sociale.

#### 3.1.2.2. BENZINA

Përdoret vetëm në transport.

#### 3.1.2.3. MAZUT

Nuk përdoret.

#### 3.1.2.4. LPG

Nuk përdoret.

### 3.1.3. THËNGJILLI



Në bazë të Vendimit të Qeverisë Nr.06/74 të dt. 06.11.2018 i ndalohet përdorimi i thëngjillit për ngrohje të objekteve të institucioneve publike. Në vitin 2018 asnjë ndërtesë në komunën e Shtimes nuk ka përdorur thëngjillin si lëndë për djegie. Mirëpo, në vitet paraprahe ka pasur përdorim të thëngjillit për ngrohje sidomos në objektet shkollore.

#### 3.1.4. BIOMASË DRURI

##### 3.1.4.1. DRU ZJARRI

Sa i përket biomasës së drurit, në Shtime përdoret më së shumti dru zjarri me 34,637 m<sup>2</sup> për ngrohje. Rrjedhimisht drutë e zjarrit janë burimi më i përdorshëm nga të gjitha burimet e tjera të energjisë.

Në mungesë të hapësirës për deponim dhe tharje të druve, drutë përdoren të sapo prerë. Djegia e drurit të sapo prerë, i cili ka përmbajtje të lartë lagështie, ka disa aspekte negative të cilat ndikojnë në parametrat operativë të sistemit të ngrohjes:

**Aspekte teknologjike** - lagështia në dru pakëson temperaturën e procesit të djegies, gjë që bënë kushte të favorshme për formimin e fundrrinës së karbonizuar. Kjo masë tenton të vendoset në sipërfaqet e shkëmbimit të nxehtësisë, gjë që redukton efikasitetin e bojlerit;

**Aspektet mjedisore** - ekziston rreziku i lartë i formimit të benzopirenit kancerogjenik në furrë, i cili nëpërmjet ajrit mund të hyjë në sistemin respirator të njeriut. Kjo mund të ndodhë në rastin e mjegullës ose nëse rezervuari është me diametër shumë të madh dhe shkarkimet nuk mund të shpërndahen në shtresat më të larta të atmosferës;

**Aspekti ekonomik** - gjithë përmbajtja e lagështirës e cila është në dru, duhet të avullohet para se të fillojë procesi i djegies. Për të zhdukur 1 kg ujë, ajo merr rreth 2500 kJ energji të ngrohjes, e cila më pas ka kaluar në mjedis. Për të avulluar lagështinë nga druri, nevojitet energji shtesë e cila është humbje e burimeve.

Prandaj, një nga aspektet që ndikon në masë të madhe në fazën e prodhimit të energjisë së ngrohjes është përcaktimi i kërkesës së kualitetit adekuat për biomasë gjatë procedurës së prokurimit.

Për shembull kriteret minimale për copë druri duhet të jenë;

- përmbajtja e hirit nën 7%;
- përmbajtja e lagështirës nën 12%;
- grimca të imta nën 1%.

#### 3.1.4.2. PELET

Peleti përdoret vetëm në objektin e Shtëpisë së Kulturës.

#### 3.1.4.3. TIJERA

Nuk aplikohen.

### 3.2. PRODHIMI I ENERGJISË

#### 3.2.1. PRODHIMI I ENERGJISË PREJ BURIMEVE TË RIPËRTRITSHME (SOLARE FOTOVOLTAIKE, SOLARE TERMALE, POMPA TË NXEHTËSISË, ERA)

Aktualisht nuk ka impiante prodhuese për energjinë nga burimet e ripërtëritshme.

#### 3.2.2. PRODHIMI I ENERGJISË PËR NGROHJE QENDRORE TË QYTETIT

Komuna e Shtimes nuk ka sistem qendror për ngrohje në nivel të qytetit. Ngruhja në ndërtesat komunale si edhe në ndërtesat private është individuale ose qendrore në nivel të ndërtesës.

### 3.3. PRODHIMI I ENERGJISË SIPAS SEKTORËVE

#### 3.3.1. PRODHIMI I ENERGJISË NË EKONOMITË FAMILJARE (NDËRTE SAT E BANIMIT)

Sektori i ndërtesave të banimit është një nga konsumatorët më të mëdhenj të energjisë në Kosovë. Megjithatë, nuk ka asnjë instrument në nivel lokal për të adresuar çështjet që lidhen me eficiency e energjisë apo BRE.

Bazuar në rezultatet e CENSUS 2011, pothuajse çdo familje në Kosovë zotëron shtëpinë e saj dhe marrja me qira e shtëpive është shumë e rrallë (2-3%). Pothuajse të gjitha banesat (99%) janë të elektrifikuara, por siç u tha më lart, lënda e drurit është burimi më i përdorur për ngrohjen e hapësirës, veçanërisht në zonat rurale.

Në Kosovë 36% e shtëpive kanë izolim termik ndërsa 47% kanë dritare me xhama të dyfishtë.

Prodhimi i energjisë në sektorin e banimit fokusohet në energjinë për ngrohje ku burimi kryesor është druri i zjarrit nëpërmjet stufave të nxemjes individuale ose qendrore në nivel të ndërtesave. Përveç drurit të zjarrit në sasi të vogël shfrytëzojnë pelet e naftë. Ndërtesat e reja në raste të rralla janë duke instaluar panele solare që shfrytëzohen për energji për ngrohje qendrore dhe ngrohje të ujit sanitar

### 3.3.2. PRODHIMI I ENERGJISË NË SEKTORIN E SHËRBIMEVE

Të dhënat nga Komuna e Shtimes që trajtohen me këtë analizë për sektorin e shërbimeve përfshinë ndërtesat komunale derisa nuk posedohen të dhëna për sektorin komercial, të bujqësisë dhe industrisë.

#### 3.3.2.1. PPRODIMI I ENERGJISË NË NDËRTESA KOMUNALE

Sipas të dhënave, janë gjithsej **38 ndërtesa publike komunale** në nën sektorin e ndërtesave në pronësi të Komunës së Shtimes dhe të përfshira në analizë, me një sipërfaqe totale të ngrohur prej **37,487m<sup>2</sup>**. Bazuar në të dhënat e komunës, këto ndërtesa konsumuan në vitin 2018.

Nr.	Burimet energjetike	Konsumi sasi për vit	Konsumi MËh për vit
1	dru	2,184 m <sup>3</sup>	3637
2	nafta	25,000 l	270
3	energji elektrike	373,291 kWh	373

Tabela 7. Konsumi i lëndëve djegëse dhe energjisë elektrike, Shtime 2018

Për vitin 2018, duke përfshirë edhe energjinë elektrike (e cila gjithashtu mund të përdoret për ndriçim dhe pajisje elektrike), që raportohet të jetë **373 MWh**, lënda djegëse më e rëndësishme që është përdorë për ndërtesat komunale në Shtime është **druri**, me një pjesëmarrje (në bazë të numrit të raportuar të konsumit) 80 %, ndërsa energjia elektrike merr pjesë me 12% dhe me 8% merr pjesë nafta.

Shih gjithashtu edhe grafikun më poshtë.




Figura 5. Konsumi i lëndëve djegëse dhe energjisë elektrike me përqindje.

### 3.3.2.2. PRODHIMI I ENERGJISË NË SEKTORI KOMERCIAL, NDËRMARRJET E VOGLA DHE TË MESME

Për sektorin komercial si dhe ndërmarrjet e vogla e të mesme nuk ka të dhëna.

### 3.3.2.3. PRODHIMI I ENERGJISË NË SHËRBIMET PUBLIKE

Ndërmarrjet publike të cilat kanë zyret e tyre në komunën e Shtimes, janë Kompania rajonale e ujësjellësit dhe kompania rajonale e mbeturinave. Komuna e Shtimes nuk ka juridiksion mbi këto kompani dhe shpenzimet e tyre i mbulojnë vetë zyret respektive. Tabela më poshtë shpreh të dhënat teknike për këto dy zyre:

**Tabela 8 - Ndërmarrjet publike**

Ndërmarrja publike	Viti i ndërtimit	Numri i të punësuarve	Sipërfaqe m <sup>2</sup>	Sipërfaqe që ngrohet m <sup>2</sup>
Kompania rajonale e ujësjellësit "Prishtina"	2012	16	240	120
Kompania rajonale e mbeturinave "Pastërtia"	2003	31	174	100

### 3.3.3. PRODHIMI I ENERGJISË NË INDUSTRI

Për sektorin industrial nuk ka të dhëna.

### 3.3.4. PRODHIMI I ENERGJISË NË BUJQËSI

Nuk ka të dhëna se sa është sasia e derivateve që përdoret gjatë një viti. Gjatë përpunimit dhe përkujdesjes për rendimentet përdoret edhe energjia elektrike sikur edhe për deponimin e frutave.

Komuna e Shtimes ka ndërmjetësuar në mes të fermerëve dhe kompanisë së shitjes së derivateve për uljen e çmimit të derivateve që përdoren për bujqësi. Kjo konsiderohet si masë stimuluese e fermerëve.

### 3.3.5. LËNDË TJERA PËR PRODHIMIN E ENERGJISË

Burimet tjera të energjisë nuk janë sasi që duhet konsiderohen andaj nuk ka të dhëna nëse përdoren edhe lëndë tjera djegëse për prodhimin e energjisë.

#### 4. ANALIZA E KONSUMIT TË ENERGJISË SIPAS SEKTORËVE

Të dhënat relevante për analizën e konsumit të energjisë në ndërtesat publike të Komunës së Shtimes u siguruan nga menaxheri i energjisë së Komunës së Shtimes. Të dhënat e energjisë janë siguruar për të gjitha ndërtesat në kuadër të komunës të grupuara në 3 sektorë si në vazhdim:

- Sektori i Ndërtesave Komunale
- Sektori i Ndrëçimit Rrugor
- Flota Komunale e Automjeteve

Tabela në vazhdim tregon konsumin e energjisë për secilin sektor shprehur në MWh për vit dhe në indikator financiar si Euro për vit si mesatare e tri viteve të fundit (2018, 2017 dhe 2016)

Tabela 9 - Konsumi i energjisë sipas sektorëve, viti 2018

Nr.	Sektori	Konsumi MWh/vit	Konsumi EUR vit
1	Ndërtesat komunale	4,303.2	€ 155,643
2	Ndrëçimi publik	113.23	€ 9,049
3	Automjetet e komunës	190.1	€ 33,715 (me mirëmbajtje)

Sipas të gjeturave më lartë del se ndërtesat publike janë shpenzuesi më i madh i energjisë në komunë me 4,303 MWh në vit, duke lënë larg në krahasim shpenzuesin e radhës i cili është Automjetet e komunës me 190.1 MWh në vit dhe ndricimi publik me 113.23 MWh në vit.

##### 4.1. KONSUMI I ENERGJISË NË NDËRTE SAT PUBLIKE

Ndërtesat publike të cilat përbëjnë stokun e tërësishëm të ndërtesave në komunën e Shtimes janë të ndara në nënsektorët si më poshtë:

- Ndërtesa administrative,
- Ndërtesa arsimore,
- Ndërtesat e shëndetësisë dhe,
- Ndërtesa kulturore dhe sportive

Në përgjithësi energjia e konsumuar tek këto ndërtesa shkon për ngrohje, ftohje, ndriçim, ujë sanitar, pajisje administarive etj. Konsumi më i madh shkon për ngrohjen e

ndërtesave<sup>4</sup> me rreth 89% pasuar nga ndriçimi me 5%, pajisjet elektrike 4% dhe uji i ngrohtë sanitar, ftohje dhe gatim së bashku përmbëjnë vetëm 2% të konsumit total.




Figura 5. Shpërndarja e konsumit të energjisë në sektorin e ndërtesave

Analiza e stokut të ndërtesave në komunën e Shtimes tregon për një tërësi ndërtesash në gjendje relativisht të mirë sa i përket aspektit termik. Kjo si rrjedhojë e renovimeve të vazhdueshme të ndërmarra nga Komuna e Shtimes si dhe ripërtëritjes së stokut ndërtimor duke ndërtuar godina të reja. Në tabelën më poshtë janë dhënë në formë tabelare gjendja e përgjithshme.

Tabela 10 - Gjendja fizike e stokut ndërtimor

Gjendja e nënsektorit	Arsim	Shëndetësi	Administratë	Kulturë	Sport
Mure të paizoluara	6	2	0	0	0
Dritare jo eficiente	4	2	0	0	0
Pa ngrohje qëndrore	3	0	0	2	2
<b>Gjithsej ndërtesa</b>	<b>23</b>	<b>6</b>	<b>3</b>	<b>2</b>	<b>2</b>

## INDIKATORËT

<sup>4</sup> Burimi MZHE, Studimi mbi shpërndarjen e konsumit të energjisë në sektorin e shërbimeve

Për të caktuar vlerën krahasimore mes ndërtesave duhet bazuar në indikatorë specifik. Gjatë analizës së të dhënave për komunën e Shtimes indikatorët kryesor të cilët janë përdorur janë kWh/m<sup>2</sup> dhe EUR/m<sup>2</sup>.

Sistemi i menaxhimit të të dhënave ENMASOFT bazon kalkulimet në indikatorët teknik gjegjësisht kWh/m<sup>2</sup>, mirëpo për rastet kur energjia e konsumuar prodhohet nga derivate që financiarisht nuk janë të favorshëm, atëhere duhet përdorur indikatorë financiar si EUR/m<sup>2</sup>.

#### 4.1.1. KONSUMI I ENERGJISË NË NDËRTESET ADMINISTRATIVE

Ndërtesat që hyjnë nën sektorin e administratës janë: Ndërtesat komunale që ofrojnë shërbime për qytetarët, ndërtesat komunale për administratën lokale, Zjarrfikësit, zyrat e komunitetit etj.

Ndërtesa që u shërbejnë qytetarëve dhe për administratën lokale janë 2 ndërtesa me sipërfaqe që ngrohet 2,456.00 m<sup>2</sup> me konsum të energjisë mesatare për 3 vite 290.74 MWh vit dhe konsum specifik të energjisë prej 118.35 kWh/m<sup>2</sup>.

Tabela më poshtë jep shpenzimet për këtë nën-sektor;

**Tabela 11 - Konsumi i energjisë në ndërtesat administrative**

Nr	Emri i institucionit	Siperfaqe që ngrohet	Konsumi i energjisë 2018		Konsumi i energjisë 2017		Konsumi i energjisë 2016	
		[m <sup>2</sup> ]	MWh	kWh/m <sup>2</sup>	MWh	kWh/m <sup>2</sup>	MWh	kWh/m <sup>2</sup>
1	Qendra për punë sociale Shtime	292	49.93	171	49.64	170	49.64	170
2	Kuvendi Komunal Shtime	2164	242.37	112	240.20	111	240.20	111
<b>E përgjithshme</b>		<b>2456</b>	<b>292.3</b>	<b>119.01</b>	<b>289.84</b>	<b>118.01</b>	<b>289.84</b>	<b>118.01</b>

#### 4.1.2. KONSUMI I ENERGJISË NË NDËRTESET E ARSIMIT SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

Në total ka 23 ndërtesa që janë nën përgjegjësinë e departamentit të arsimit por dy nga këto shkolla tanimë janë të mbyllura. Në aspektin e ngrohjes vetëm tri nga 21 ndërtesat nuk kanë ngrohje qëndrore të instaluar.

**Tabela 12 - Konsumi i energjisë në ndërtesat e nën-sektorit të arsimit**

Nr	Emri i institucionit	Siperfaqe qe ngrohet	Konsumi i energjise 2018		Konsumi i energjise 2017		Konsumi i energjise 2016	
			MWh	kWh/m <sup>2</sup>	MWh	kWh/m <sup>2</sup>	MWh	kWh/m <sup>2</sup>

		[m2]						
1	SHFMU "Emin Duraku" shkolla e vjeter	2,722	264.37	97.1	266.71	98.0	269.55	99.0
2	SHFMU "Emin Duraku" shkolla e re	4,226	370.74	87.7	370.05	87.6	382.05	90.4
3	SHFMU "Emin Duraku" Davidovc	695	89.07	128.2	89.83	129.3	87.92	126.5
4	SHFMU "Emin Duraku" Lagje e Pajtimimit	227	51.04	224.8	50.40	222.0	77.81	342.8
5	SHFMU "Emin Duraku" Belincë	425	50.87	119.7	51.69	121.6	58.64	138.0
6	SHFMU "Bajram Curri" Petrovë	1,066	155.39	145.8	154.22	144.7	155.47	145.8
7	SHFMU "Bajram Curri" Mollopolc	407	100.64	247.3	100.91	247.9	100.86	247.8
8	SHFMU "Skenderbeu" Reçak	1,639	407.38	248.6	407.38	248.6	404.58	246.8
9	SHFMU "Hasan Prishtina" Godanc	2,168	255.41	117.8	256.55	118.3	255.87	118.0
10	SHFMU "Abdullah Shabani" Carrallevë	1,225	132.86	108.5	134.48	109.8	133.58	109.0
11	SHFMU "Abdullah Shabani" Zborc	739	87.38	118.2	87.64	118.6	87.16	117.9
12	SH.M.L -Gjimnazi "Naim Frashëri" Shtime	2,269	216.08	95.2	217.76	96.0	228.89	100.9
13	SHFMU "Idriz Ajeti" Pjetërshiticë	511	154.11	301.6	155.56	304.4	155.81	304.9
14	SHFMU "Lasgush Poradeci" - Rashincë	500	68.66	137.3	67.95	135.9	135.86	271.7
15	SHFMU "Lasgush Poradeci" - Gjurkoc	400	69.45	173.6	69.03	172.6	92.42	231.1
16	SHFMU "Lasgush Poradeci" - Muzeqinë	785	154.06	196.3	154.80	197.2	153.96	196.1
17	SHFMU "Lasgush Poradeci" - Vinovc	700	84.61	120.9	84.51	120.7	84.44	120.6
18	SHFMU "Lasgush Poradeci" - Gllavicë	420	83.98	200.0	83.97	199.9	83.52	198.9
19	Institucioni Parashkollor "Albiona Asllani"	362	41.55	114.8	50.18	138.6	49.39	136.4
20	SHFMU "Idriz Ajeti" Karaqicë	252	41.63	165.2	42.99	170.6	44.00	174.6
21	Shkolla e lartë profesionale	6,512	536.17	82.3	534.95	82.1	538.28	82.7

Nga ky stok i ndërtimit, disa shkolla kanë numër të vogël të nxënësve dhe nuk parashihet investim në renovimin e tyre. Këto shkolla janë si më poshtë:

Tabela 13 - Shkollat me numer te nxënësve nën 84

Shkolla	Siperfaqe që ngrohet	Numri i nxënësve
SHFMU "Emin Duraku" Lagje e Pajtimimit	227	60
SHFMU "Emin Duraku" Belincë	425	65



SHFMU " Lasgush Poradeci " - Gllavicë	420	26
SHFMU "Idriz Ajeti" Karaqicë	252	9




Figura 6. Energjia specifike në ndërtesat e nën-sektorit të arsimit

#### 4.1.3. KONSUMI I ENERGJISË NË NDËRTESAT E NËN-SEKTORIT TË SHËNDETËSISË

Komuna e Shtimes si qeverisje lokale është përgjegjëse vetëm për sistemin e kujdesit shëndetësor parësor, i cili përfshin qendrën kryesore të kujdesit shëndetësor familjar, qendrat e mjekësisë familjare dhe ambulancat.

Tabela më poshtë tregon konsumin e energjisë në tri vitet e fundit:

Tabela 14 - Konsumi i energjisë në ndërtesat e shëndetësisë:

Nr	Emri i institucionit	Siperfaqe qe ngrohet [m2]	Konsumi i energjisë 2018		Konsumi i energjisë 2017		Konsumi i energjisë 2016	
			MWh	kWh/m2	MWh	kWh/m2	MWh	kWh/m2
1	QKMF, Shtime	2192	367.08	167.46	299.41	136.59	294.18	134.20
2	QMF, Petrovë	119	8.23	69.16	8.97	75.35	8.73	73.38
3	QMF, Pjetërshticë	112	19.03	169.89	14.60	130.37	14.85	132.62
4	QMF, Muzeqinë	162	29.54	182.33	23.37	144.29	26.04	160.72

5	Shtëpia e personave me aftësi të kufizuar dhe ngecje mendore	394	64.91	164.73	78.44	199.08	73.71	187.08
---	--	-----	-------	--------	-------	--------	-------	--------

Bazuar në të dhënat për konsumin e energjisë, mesatarisht këto ndërtesa konsumojnë energji rreth 443.7 MWh vit ose shprehur në konsum specifik 148.94 kWh/m<sup>2</sup> \*vit.

Sa i përket sistemit të ngrohjes qendrore, të gjitha ndërtesat kanë kaldaja për ngrohje qendrore me dru, dhe vetëm Shtëpia e personave me aftësi të kufizuar dhe ngecje mendore ka kaldajë me naftë.




Figura 7. Konsumi specifik i energjisë te ndërtesat shëndetësore

Në këtë tabelë është prezantuar energjia specifike në ndërtesat e shëndetësisë ku shtëpia e personave me aftësi të kufizuara ka konsumin më të lartë specifik.


#### 4.1.4. KONSUMI I ENERGJISË NË NDËRTE SAT E KULTURËS E SPORTIT

Janë vetëm tri ndërtesa të kulturës dhe sportit: Shtëpia e kulturës, Muzeu i qytetit dhe Stadiumi i qytetit.

Tabela 15 prezanton konsumin e energjisë në këto ndërtesa e që është mjaft i ulët sepse nuk ngrohen në tërësi.

**Tabela 15 - Konsumi i energjisë në ndërtesat për kulturë e sport**

Nr	Emri i institucionit	Sipërfaqe që ngrohet [m <sup>2</sup> ]	Konsumi i energjisë 2018		Konsumi i energjisë 2017		Konsumi i energjisë 2016	
			MWh	kWh/m <sup>2</sup>	MWh	kWh/m <sup>2</sup>	MWh	kWh/m <sup>2</sup>
1	Shtëpia e Kulturës	1,965	35.24	17.93	47.86	24.35	294.18	18.1
2	Muzeu i Qytetit	150	0.33	2.19	3.91	26.08	8.73	16.4
3	Stadiumi i qytetit	40	1.29	32.33	1.04	25.95	14.85	25.1



**Figura 8 - Konsumi specifik i energjisë te ndërtesat e kulturës dhe sportit**

#### 4.1.5. KONSUMI I ENERGISË TE NDRIÇIMI PUBLIK

Rrjeti i ndriçimit rrugor është shumë i vjetër dhe i mbingarkuar, i cili çon shpesh në defekte të tilla si djegia të transformereve dhe instalimeve elektrike. Kjo është sidomos e shprehur në zonat ku shtëpitë janë më të dendura. I gjithë ndriçimi i rrugëve në Shtime është pronë e vetme e autoriteteve lokale, gjë që ka mundësuar të dhëna të sakta për konsumimin e energjisë.

Sipas llojit të llampave të instaluara mund të thuhet se ndriçimi publik në komunën e Shtimes është tashmë eficient duke pasur parasysh se mbi 87% të llampave janë LED dhe CFL dhe vetëm 12.6% janë nga Zhiva.

Tabela më poshtë ilustron gjendjen e përgjithshme të ndriçimit në komunën e Shtimes:

**Tabela 16 - Llojet e llambave dhe kapaciteti i instaluar**

	Zhivë	CFL	Natrium	Halogjen	LED	total
Nr. i llambave	107	101	0	0	666	874
Kapaciteti [kW]	5.74	2.39	0	0	37.3	45.43
Kapaciteti [%]	12.6	5.3	0.0	0.0	82.1	100

Sa i përket konsumit të energjisë elektrike, komuna e Shtimes ka konsumuar energji elektrike për ndriçimin publik prej 134.6 MWh/vit për vitin 2018, ndërsa 10.47 MWh/vit për vitin 2017 dhe 84.3 MWh/vit për vitin 2016. Trendi i rritjes tregon për ngritjen dhe zgjerimin e rrjetit të ndriçimit publik me investime të vazhdueshme të komunës në këtë drejtim.

#### 4.1.6. ANALIZA E STOKUT NDËRTIMOR

Analiza e të dhënave për konsum specifik të energjisë të ndërtesave tregon se konsumi i energjisë i raportuar me nivel më të lartë është në sektorin e Arsimit pasuar nga ndërtesat e sektorit të Shëndetësisë dhe Administratës. Ndërtesat e Kulturës e Sportit janë me konsum të ulët.

Më poshtë në tabelë e grafik janë paraqitur konsumi i përgjithshëm në MWh sipas sektorëve.

Tabela 17 - Konsumi i përgjithshëm sipas nën-sektorëve:

Sektori\viti	Konsumi i përgjithshëm MWh vit			Konsumi mesatar MWh vit
	2016	2017	2018	
Arsimi	3,453.2	3,431.5	3,415.4	3,433.0
Administrata	289.8	289.8	292.3	290.7
Shëndetësia	417.5	424.8	488.8	443.7
Kulturë/Sport	317.8	52.8	36.9	135.8
Total	607.6	342.7	329.2	4,303.5

Nga tabela më sipër mund të shihet se nën-sektori i arsimit është njëherit edhe konsumuesi më i madh i energjisë në sektorin e ndërtesave komunale. Në tërësi 77% e energjisë së konsumuar për ngrohje, ndriçim, ftohje, ujë të ngrrohtë sanitar për nevojat e ndërtesave komunale konsumohet nga 23 ndërtesat shkollore të kësaj komune. Sektori me konsumin më të ulët është Kulturë dhe Sport sepse në këto ndërtesa nuk ka aktivitete të përhershëm por edhe meqenëse kanë sipërfaqe relativisht të mëdha për arsye të kursimit të energjisë, ato nuk ngrohen fare.

Grafiku më poshtë shfaq shpërndarjen e energjisë brenda sektorit të ndërtesave komunale.




Figura 6. Konsumi i përgjithshëm sipas nën-sektorëve

Në mënyrë që të kemi një analizë të fortë të stokut të ndërtesave, ndërtesat do të përjashtohen për analiza të mëtejshme nëse plotësohen tre treguesit e mëposhtëm:

- Ndërtesat për të cilat nuk kanë ofruar informacione për sipërfaqen e përgjithshme që ngrohet dhe nuk janë ofruar të dhëna për konsumin e lëndëve djegëse për prodhimin e ngrohjes duke rezultuar se këto ndërtesa janë jashtë përdorimit.
- Ndërtesat me vlera të ulëta të konsumit specifik të energjisë, më pak se 80 kWh/m<sup>2</sup>, të cilat do të tregojnë se ndërtesa të tilla tashmë ishin mjaft efikase për energji;
- Shkollat me numër të nxënësve më të vogël se 84 nxënës të cilat sipas Udhëzimit Administrativ 04/2018 të MASHT, për investime kapitale, nuk lejohen për renovim (përjashtim zonat kufitare).

Lista e ndërtesave komunale me konsum të ulët nën 80 kWh në vit:

Tabela 18 - Konsumi i energjisë në ndërtesat nën 80 kWh vit

	Emri i Institucionit	Konsumi specifik kWh/m <sup>2</sup>
7	Shtëpia e Kulturës	18
8	Muzeu i qytetit	16
9	Stadiumi i qytetit	25

Gjithashtu janë identifikuar disa ndërtesa të cilat gjatë vitit 2018 nuk janë më në funksion dhe këto janë:

Shkolla fillore Bajram Curri në fshatin Llanishtë dhe Bajram Curri në fshatin Topillë, QMF në fshatin Godanc, Shtabi i UÇK-s në Pjetërshicë i cili është duke u renovuar.

#### 4.1.1. TË TJERA - INFRASTRUKTURA

Infrastruktura e komunës së Shtimes është zhvilluar në përputhje me planet urbanistike dhe strategjitë e zhvillimit, për rrjedhojë në një periudhë rreth 13 vjeçare janë investuar 34.712.467 Euro në 401 projekte, të cilat janë destinuar për shtrimin e rrugëve (122.76 km); ndërtimin e ujë sjellësve (104.1 km), kanalet e ujrave të zeza (52.15 km) si dhe shtrim trotuaresh, sipërfaqe të gjelbëruara, ndriçim publik. Fshatrat e Komunës janë të lidhura me rrugë të asfaltuara me qytetin e Shtimes, duke krijuar në këtë mënyrë një avantazh për zhvillimet e mëtejshme ekonomike dhe sociale të zonës.

#### 4.2. KONSUMI I ENERGJISË NË SHËRBIMET PUBLIKE

Komuna e Shtimes ka raportuar, për kompanitë publike të ujësjellësit dhe mbeturinave por të cilat nuk janë në pronësi të komunës sepse janë rajonale. Prandaj, analiza e thellë e konsumit të energjisë nuk ka qenë relevante.

Tabela 19 - Ndërmarrjet publike

Ndërmarrja publike	Viti i ndërtimit	Numri i të punësuarve	Sipërfaqe m <sup>2</sup>	Sipërfaqe që ngrohet m <sup>2</sup>
Kompania rajonale e ujësjellësit "Prishtina"	2012	16	240	120
Kompania rajonale e mbeturinave "Pastërtia"	2003	31	174	100

#### 4.2.1. KONSUMI I ENERGJISË NË FURNIZIMIN ME UJË DHE SEKTORIN E UJËRAVE TË ZEZA

Në komunën e Shtimes janë të evidentuara 8 resurse të ujit (një burime dhe 7 puse Caralevë, Shtime 5 dhe Rashincë 2) të cilat shfrytëzohen për furnizim qendror të popullatës me ujë të pijshëm, dhe janë të menaxhuara nga ujësjellësi. Të gjitha këto resurse ndodhen në pjesën e identifikuar si zona e zhvillimit aktiv dhe furnizojnë 97.55% të popullatës të komunës. Kapacitetet ekzistuese të resurseve të ujit, rreth 80 l/sec, që momentalisht janë në shfrytëzim, ofrojnë rreth 180-200 l/banor/ditë, llogaritet të jenë të mjaftueshme për plotësimin e kërkesave ditore për ujë të qytetarëve të kësaj zone krahasuar me standardet e BE.

Përafërsisht mbi 70% e popullatës së Shtimes janë jashtë rrjetit të kanalizimit. Konfiguracioni i relievit në komunën e Shtimes i mundëson asaj që në të ardhmen të ketë një shtrirje të rrjetës së kanalizimit në formë lineare përgjatë rrjedhave lumore, ku me një linjë kryesore të kanalizimit mundësohet grumbullimi i mbi 80%, të të gjitha ujërave të zeza nga

vendbanimet e zonës aktive zhvillimore deri tek impianti për ujërat e zeza i cili është i propozuar të ndërtohet në bashkëpunim me komunën e Lipjanit (sipas planit hapësinor të Kosovës).<sup>5</sup>

#### 4.2.2. KONSUMI I ENERGJISË NË SEKTORIN E MBLEDHJES SË MBETURINAVE

Mbledhja e mbeturinave në Komunën e Shtimes bëhet nga Kompania Regjionale e Mbeturinave "Pastërtia". Shpenzimet e energjisë i mbulon vet ndermarrja.

Shërbim të menaxhimit të mbeturinave kanë 10 vendbanime, kurse 11 vendbanime tjera nuk e kanë këtë shërbim. Në bazë të analizave të bëra ky shërbim është ende në shkallë të ultë ku vetëm 40% e shtëpive kanë qasje.

Po që se merret mesatarja e sasisë së përgjithshme të mbeturinave për kokë banori (2 kg për një ditë), atëherë vlerësohet se sasia mesatare e prodhimit të mbeturinave është 67600kg në ditë ose 24674000kg në vit (24674t) duke mos llogaritur objektet afariste dhe objektet tjera që s'kanë dedikim banimi. KRM "Pastërtia" Sh.a transporton rreth 1800t mbeturina në vit në deponinë regjionale në Ferizaj. Përfshirja në shërbimin e grumbullimit të mbeturinave është e domosdoshme, nga se 11 vendbanime mbeturinat i hedhin në mjedis. Në vendbanimet që nuk kanë shërbime të mbeturinave duhet të pastrohen vendgrumbullimet ilegale, sidomos ato në toka kualitative dhe të propozohet që në largësi nga vendbanimi së paku 150 m të caktohet vend grumbullimi i mbeturinave në tokat që kanë vlerë më të ultë, ku mund të deponohen mbeturinat shtëpiake. Krahas qasjes në sistem të grumbullimit të mbeturinave njëkohësisht inspektori për mjedis duhet të pastroj pikat ilegale me mbeturina dhe duhet aplikoj masat Ligjore në fuqi për mbrojtjen e mjedisit.

Vitet e fundit, bujqësia ka marrë një zhvillim të ri për shkak të kultivimit në mënyrë intensive të kulturave bujqësore, por dhe rritjes së vetëdijes së fermerëve që bujqësia është prioritet zhvillimor në komunën Shtime. Vetëm gjatë këtyre viteve të fundit janë ngritur rreth 30 ha pemishte me mollë dhe kumbull (të kultivuara në mënyrë intensive); mbi 2 ha sera për kultivimin e perimeve dhe luleve; rreth 20 ha me perime në sipërfaqe të hapura dhe rreth 30 ha me lakër. Impakt në zhvillimin e bujqësisë komunale kanë dhënë dhe projektet e subvencionet e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.<sup>6</sup>

Mjetet motorike për punët në bujqësi janë kryesisht të vjetra sikur edhe automjetet andaj subvencionimi i mjeteve motorike efikente do të kontribuonte në uljen e konsumit të energjisë si dhe uljen e ndotjes së ajrit.

<sup>5</sup> Plan i zhvillimor komunal Stime 2009-2020

<sup>6</sup> SZHEL Shtime 2014-2018

#### 4.3. KONSUMI I ENERGIJË NË SEKTORIN E TRANSPORTIT

Sektori i transportit është një nga konsumatorët më të mëdhenj të energjisë. Në Bashkimin Evropian në vitin 2010 sektori i transportit konsumoi 31,7% të totalit të konsumit final të energjisë.

Njëri ndër problemet kryesore që paraqitet si pasojë e ndotjes nga transporti është emisioni i lartë i gazrave nga lëndët djegëse të automjeteve siç janë: CO<sub>2</sub>, NO<sub>x</sub>, SO<sub>2</sub>, CO<sub>2</sub>. Emisionet nga automjetet shkaktojnë pjesën më të madhe të ndotjes me metalet e rënda siç janë Pb, etj. Koncentrimi më i madh i kësaj ndotje nga qarkullimi i automjeteve është përgjatë rrugës kryesore Prishtinë - Shtime – Prizren. Hapja e rrugës transite ne gjysmën e dytë të vitit 2007 ka bërë të mundur mënjanimin e kësaj ndotje. Sipas 4 mostrave të marruara në hyrje të Komunës së Shtimes llogaritet mesatarja e qarkullimit të automjeteve për ditë është rreth 6000 automjete pa llogaritur lëvizjet e brendshme të qytetit dhe fshatrave që lidhen në mes vete. Në bazë të llogaritjeve, rezultati përfundimtar është 10560 litra derivate djegie nga automjetet në gjatësi 17.6 km nga pika hyrëse në Shtime nga Lipjani dhe pika dalëse në kufi me Suharekën. Ose 600 litra për km.

Llogaritja:

- Mesatarja për automjet 10 / litër
- Mesatarja për km 600 / litër
- Nr automjeteve 6000 / ditë
- Djegie 10560 / ditë përgjatë rrugës kryesore me gjatësi 17.6 km

Tranziti lokal dhe regional është planifikuar të ndërtohet në pjesën lindore të qytetit, në anën e djathtë të rrugës Shtime – Prizren<sup>7</sup>.

Konsumi i energjisë në sektorin e Transportit do të analizohet në dy sektorë:

- Flota e automjeteve të komunës;
- Transporti Publik

##### 4.3.1. FLOTA E AUTOMJETEVE KOMUNALE

Nësektori i automjeteve në pronësi të Komunës së Shtimes përfshin autoparkun prej 14 automjeteve në shërbim të komunës e të cilat kanë vit të prodhimit prej 1999 – 2014.

Sasia e konsumuar e derivateve është 16,247 l.

Në tabelën 14 janë paraqitur shpenzimet për karburantet e konsumuara të automjeteve nga auto parku në pronësi të Komunës së Shtimes në vitin 2018.

<sup>7</sup> Plani zhvillimor komunal Stime 2009-2020



Tabela 20 - Shpenzimet e karburantit nga automjetet në pronësi të Komunës

Pronari/shfrytëzuesi/ përfituesi	Klasa e automjetit	Regjistrimi i parë	Vëllimi i motorrit	Karb.	Hargjimi i karburantit	Hargjimi vjetor i karburantit	Shpenzimet vjetore për mirëmbajtje
			cm <sup>3</sup>		l/100 km	litra	EUR
Komuna Shtime	Klasa 2	2008	2000	dizel	7.8	1136	1224.1
Komuna Shtime	Klasa 2	2005	2000	dizel	8.1	1245	1340.9
Komuna Shtime	Klasa 2	2005	2000	dizel	7.9	963.7	1043.7
Komuna Shtime	Klasa 2	2005	1900	dizel	7.04	1210	1299.5
Komuna Shtime	Klasa 2	1999	3000	dizel	12.3	1029	1109.38
Komuna Shtime	Klasa 2	1999	3000	dizel	12.6	1015	1089.94
Komuna Shtime	Klasa 2	2004	3000	dizel	12.99	1429	1530.44
Komuna Shtime	Klasa 2	2001	1900	dizel	9.99	289	311.5

Pronari/shfrytëzuesi/ përfituesi	Klasa e automjeti t	Regjistrimi i parë	Vëllimi i motorrit	Karbur anti	Hargjimi i karburantit	Hargjimi vjetor i karburantit	Shpenzime t vjetore për mirëmbajtj e
			cm <sup>3</sup>		l/100 km	litra	EUR
QKMF "Dr. Vezir Bajrami"	Klasa 3	1999	2779	Dizel	8.78	469	1349
QKMF "Dr. Vezir Bajrami"	Klasa 3	2014	1968	Dizel	12.4	2655	1048
QKMF "Dr. Vezir Bajrami"	Klasa 3	2009	1896	Dizel	12.1	2655	1172
QKMF "Dr. Vezir Bajrami"	Klasa 3	2000	2779	Dizel	7.33	461	1379
QKMF "Dr. Vezir Bajrami"	Klasa 3	2014	1968	Dizel	10.7	936	362
Qendra për Punë Sociale	Klasa 2	2002	1951	Dizel	9.16	755	782

Tabela më poshtë tregon konsumin e tërësishëm të energjisë nga automjetet komunale:

Tabela 21 - Konsumi i përgjithshëm i energjisë nga automjetet komunale

	Emri i institucionit	Konsumi litra	Konsumi MWh
1	Komuna Shtime -QKMF	7931 litra dizel	85.65
2	Komuna shtime - tjera	8317 litra dizel	89.85
	<b>Total</b>	<b>16,247.7 litra dizel</b>	<b>175.5</b>

#### 4.3.2. TRANSPORTI PUBLIK

Sipas dokumentit Strategjia e Zhvillimit ekonomik lokal, prioritare për komunën e Shtimes do të ishte ndërtimi i vend lokacionit për ndaljen dhe parkimin e autobusëve në qytetin e Shtimes. Ky është projekti i cili do të ndihmoj lidhjen me transportin lokal dhe regjional të udhëtarëve në komunën e Shtimes, i cili do të ofroj shërbime të kënaqshme për banorët dhe kompanitë e transportit si dhe do të mundësoj një lidhje më të koordinuar të linjave të transportit lokal dhe regjional.

#### 4.4. KONSUMI I PËRGJITHSHËM I ENERGJISË

Meqenëse për sektorët e bujqësisë, industrisë dhe shërbimeve publike (regjionale) nuk ka të dhëna mbi konsumin e energjisë sepse nuk janë njësi buxhetorë të Komunës, atëherë tërësia e konsumit të energjisë në komunë përfshinë vetëm sektorët e ndërtesave, transportin komunal dhe ndriçimin public. Këto të dhëna janë përmbledhur në tabelën e mëposhtme:

Tabela 22 - Kumulativi i konsumit të energjisë në komunë:

	Emri i institucionit	Dru zjarri	Dizel/naftë	Energji elektrike
	Njësia	MWh/vit	MWh/vit	MWh/vit
1	Sektori i ndërtesave publike	3637	270	373
2	Sektori i transportit	0	175.5	0
3	Sektori i ndriçimit publik	0	0	134.6
	<b>Total MWh/vit</b>	<b>3637</b>	<b>345.5</b>	<b>507.6</b>

## 5. ANALIZA E POTENCIALIT TË EFIÇIENCËS SË ENERGJISË SIPAS SEKTORËVE

Sikur edhe janë prezantuar më lartë ndërtesat publike në Komunën e Shtimes konsumojnë shumë energji. Edhe pse disa nga ndërtesat janë renovuar dhe riparuar në aspekt të konsumit të energjisë prap ekziston potencial i konsiderueshëm për efiçencë të energjisë në ato objekte.

Potenciali i Efiçencës së energjisë në stokun e ndërtesave në komunën e Shtimes është definuar në bazë të përlogaritjeve të kursimeve që mund të arrihen nga ndryshimet/përmirësimet realisht të arritshme ndërmjet konsumit aktual të energjisë dhe konsumit të energjisë pas zbatimit të masave të qëndrueshme të efiçencës së energjisë.

Vlera e potencialit energjetik përcaktohet nga parametrat e mëposhtëm:

- Kushtet aktuale,
- Investimet e nevojshme,
- Niveli real i zbatimit të masave të efiçencës së energjisë

### 5.1. SEKTORI I SHËRBIMEVE

#### 5.1.1. NDËRTEESAT PUBLIKE

Vlerësimi i potencialit të kursimit të energjisë të ndërtesave është llogaritur vlera specifike e energjisë mbi 80 kWh/m<sup>2</sup>. Në tërësi në Komunën e Shtimes ka 27 ndërtesa publike komunale me një konsum të tillë, pra me të lartë se 80 kWh/m<sup>2</sup>, dhe me një potencial total të kursimit për këto 27 ndërtesa komunale prej 905.6 MWh në vit.

Potenciali për kursimin e energjisë është radhitë sipas nënsektorëve sikur janë analizuar sa i përket konsumit të energjisë dhe si total është dhënë në tabelën më poshtë:

**Tabela 23 - Potenciali i gjithmbarshëm për kursim në sektorin e ndërtesave publike:**

Nësektori	Potenciali i kursimit MWh/ vit
Administratë	94.2
Arsim	1081.4
Shëndetësi	206.3
Kulturë/sport	0.0
<b>Gjithsej</b>	<b>1381.9</b>

### 5.1.1.1. NDËRTESTASAT E ADMINISTRATËS

Ndërtesat e administratës janë vetem dy sosh. Tabela në vijim jep pasqyrën e konsumit, në raport me sipërfaqen dhe potenciali i kursimit në ndërtesat e Administratës:

**Tabela 24 - Potenciali i kursimit në ndërtesat e Administratës:**

Nr	Emri I institucionit	Siperfaqe që ngrohet	Mesatare 3 vite	Potenciali	
		m <sup>2</sup>	kWh/m <sup>2</sup>	<80 kWh/m <sup>2</sup>	MWh/ vit
1	Qendra për Punë Sociale Shtime	292	170.33	90.33	26.38
2	Kuvendi Komunal Shtime	2164	111.33	31.33	67.81
<b>E përgjithshme</b>		<b>2456</b>	<b>118.35</b>		<b>94.18</b>

### 5.1.1.2. NDËRTESTASAT E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

Ndërtesat e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë paraqesin potencial kursimi të madh. Disa ndërtesa janë renovuar derisa ky stok ka edhe numrin e shfrytëzuesve më të madh po ashtu edhe sipërfaqen më të madhe.

Tabela në vijim pasqyron konsumin dhe potencialin e kursimit në këtë sektor:

**Tabela 25 - Potenciali i kursimit në ndërtesat e arsimit, shkencës e teknologjisë:**

Nr	Emri I institucionit	Siperfaqe qe ngrohet [m <sup>2</sup> ]	Mesatare 3 vite	Potenciali	
			kWh/m <sup>2</sup>	<80 kWh/m <sup>2</sup>	MWh/ vit
1	SHFMU "Emin Duraku" shkolla e vjeter	2,722	98.0	18.0	49.12
2	SHFMU "Emin Duraku" shkolla e re	4,226	88.6	8.6	36.20
3	SHFMU "Emin Duraku" Davidovc	695	128.0	48.0	33.34
6	SHFMU "Bajram Curri" Petrove	1,066	145.4	65.4	69.75
7	SHFMU "Bajram Curri" Mollopolc	407	247.7	167.7	68.24
8	SHFMU "Skenderbeu" Reçak	1,639	248.0	168.0	275.32
9	SHFMU "Hasan Prishtina" Godanc	2,168	118.1	38.1	82.51
10	SHFMU "Abdullah Shabani" Carralevë	1,225	109.1	29.1	35.64
11	SHFMU "Abdullah Shabani" Zborc	739	118.3	38.3	28.27
12	SH.M.L -Gjimnazi "Naim Frashëri" Shtime	2,269	97.4	17.4	39.39
13	SHFMU "Idriz Ajeti" Pjetërshticë	511	303.6	223.6	114.28
14	SHFMU " Lasgush Poradeci " - Rashincë	500	181.6	101.6	50.82
15	SHFMU " Lasgush Poradeci " - Gjurkoc	400	192.4	112.4	44.97
16	SHFMU " Lasgush Poradeci " - Muzeqinë	785	196.5	116.5	91.48
17	SHFMU " Lasgush Poradeci " - Vinovc	700	120.7	40.7	28.52
19	Institucioni Parashkollor "Albiona Asllani"	362	129.9	49.9	18.08
21	Shkolla e lartë profesionale	6,512	82.4	2.4	15.50
<b>E pergjithshme</b>		<b>28,250</b>	<b>123.0</b>		<b>1,081.42</b>

### 5.1.1.3. NDËRTESAT E MIJËKËSISË FAMILJARE

Ndërtesat e shëndetësisë në në Komunën e Shtimes paraqesin po ashtu potencial kursimi. Atë e dëshmon tabela në vijim:

**Tabela 26 - Potenciali i kursimit në ndërtesat e Shëndetësisë**

Nr	Emri i institucionit	Siperfaqe që ngrohet	Mesatare 3 vite	Potenciali	
		[m <sup>2</sup> ]		kWh/m <sup>2</sup>	<80 kWh/m <sup>2</sup>
1	QKMF, Shtime	2192	146.09	66.09	144.86
3	QMF, Pjetërshticë	112	144.30	64.30	7.20
4	QMF, Muzeqinë	162	162.44	82.44	13.36
5	Shtëpia e personave me aftësi të kufizuar dhe ngecje mendore	394	183.63	103.63	40.83
<b>E përgjithshme</b>		<b>2979</b>			<b>206.25</b>

### 5.1.1.4. KULTURA DHE SPORTI

Ndërtesat e kulturës dhe sportit janë konsideruar jo me interes sa i përket potencialit për kursim të energjisë. Këtë e dëshmon tabela në vijim:

**Tabela 27 - Potenciali i kursimit në ndërtesat e Kulturës dhe Sportit**

Nr	Emri i institucionit	Siperfaqe qe ngrohet [m <sup>2</sup> ]	Mesatare 3 vite	Potenciali
			kWh/m <sup>2</sup>	<80 kWh/m <sup>2</sup>
1	Shtëpia e Kulturës	1,965	35.5	-44.5
2	Muzeu i Qytetit	150	2.5	-77.5
3	Stadiumi I qytetit	40	1.0	-79.0
<b>E përgjithshme</b>		<b>2155</b>		<b>-80.0</b>

### 5.1.1.5. NDRIÇIMI PUBLIK

Meqë një numër i konsiderueshëm i llambave, në Shtime, janë jo efçiente, rekomandohet ndërrimi i këtyre llambave që do të rezultonte me kursim prej 18.3 kWh/vit.

**Tabela 28 - Llogaritja e potencialit të kursimit te sektori i ndriçimit publik**

Llamba zhivë				Llamba LED			
Nr. I llambave	Kapaciteti	Gjithsej kapaciteti	Konsumi vjetor	Kapaciteti	Konsumi pas intervenimit	Konsumi vjetor	Kursimi
Cope	W	W	MWh	W	kW	MWh	MWh
68	50	3400	3.36	20	1360	1.35	2

### 5.1.1.6. SHËRBIMET KOMUNALE

Këto shërbime janë përfshirë në kuadër të ndërtesave.

#### 5.1.2. SHËRBIMET PUBLIKE

Shërbimet publike sikurse janë furnizimi me ujë të pijës, rrjeti i kanalizimit dhe mbledhja e mberturinave, si shërbime organizohen dhe funksionojnë në kuadër të kompanive regionale dhe nuk janë në juridiksion të komunës. Megjithatë komuna ka në domen të saj punët infrastrukturore për ofrimin e këtyre shërbimeve ku edhe investimet janë mjaft intensive.

#### 5.2. BUJQËSIA

Nuk ka të dhëna për këtë sektor.

#### 5.3. TRANSPORTI

##### 5.3.1. FLOTA KOMUNALE

Meqenëse komuna e Shtimes ka një flotë relativisht të vogël të automjeteve edhe potenciali për kursim aty është relativisht i vogël. Nëse mirret parasysh konsumi vjetor i derivateve prej 8949 litra në vit dhe përafërisht 222 ditë pune në vit del se automjetet e komunës (pa sektorin e shëndetësisë), harxhojnë mesatarisht 5.03l në ditë, që duke pasur parasysh terrenin malor të komunës së Shtimes nuk është konsum i lartë andaj edhe nuk ka potencial për kursim.

Spektori i shëndetësisë ka shumicën e automjeteve të kategorisë 3 të cilat shpenzojnë më shumë derivate për km rrugë. Mesatarisht një automjet i sektorit të shëndetësisë shpenzon 5.99 litra derivate në ditë. Llogaritur që rrugët e kryera përfshijnë edhe gravitimin e Qendrave spitalore tjera si Spitali regional në Ferizaj dhe QKUK Prishtinë atëherë ky konsum nuk është i lartë dhe rrjedhimisht kursimi është në margjina të vogla.

##### 5.3.2. TRANSPORTI KOMUNAL

Kursime reale dhe të matshme në këtë sektor është vështirë të përcaktohen, andaj mundësitë duhet cekur vetëm në formë të objektivave dhe jo plane veprimi të veçanta.

- Krijimi i transportit publik të përshtatshëm, të sigurt dhe atraktiv (çmimi, shërbimi);
- Promovimi dhe mbështetja e ecjes dhe çiklizmit
- Mjetë për bartjen në transport, ndërtimi i shtegut për bicikleta, etj.

Krijimi i me shumë linjave për autobus dhe shtigjeve për ciklizem.

### 5.3.3. POTENCIALI I KURSIMIT NGA SEKTORËT TJERË

Sektorët tjerë edhe pse mund të kenë potencial për kursimin e energjisë, komuna nuk është përgjegjëse për shpenzimet e tyre andaj në mungesë të të dhënave edhe nuk është shqyrtuar potenciali për kursim.

### 5.4. POTENCIALI I PËRGJITHSHËM I KURSIMIT TË ENERGIJISË

Potenciali për kursim të energjisë do të analizohet në dy sektorë: Stokun e ndërtesave komunale në komunën e Shtimes që përbëhet nga ndryshime / përmirësime realisht të arritshme duke krahasuar konsumin aktual të energjisë dhe konsumin e energjisë pas zbatimit të masave të qëndrueshme të efijencës së energjisë dhe Ndrëçimin Publik në Komunën e Shtimes që përfshinë ndrrimin e llambave të Zhivës me Llamba LED.

Vlera e potencialit për efijencë energjetike përcaktohet nga parametrat e mëposhtëm:

- Kushtet aktuale,
- Investimet e nevojshme,
- Niveli real i zbatimit të masave të efijencës së energjisë

Potenciali për kursimin e energjisë është si më poshtë:

Tabela 29 - Potenciali i gjithmbarshëm për kursim në sektorin e ndërtesave publike:

Nësektori	Potenciali I kursimit MWh/ vit
Administratë	94.2
Arsim	1081.4
Shëndetësi	206.3
Kulturë/sport	0.0
<b>Gjithsej</b>	<b>1381.9</b>

Tabela 30 - Llogaritja e potencialit të kursimit te sektori i ndrëçimit publik:

Nr. I llambave	Llamba zhivë			Llamba LED			
	Kapaciteti	Gjithsej kapaciteti	Konsumi vjetor	Kapaciteti	Konsumi pas intervenimit	Konsumi vjetor	Kursimi
Cope	W	W	MWh	W	kW	MWh	MWh
